

**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS**

**KOSADA**

**RREGULLAT KOMBËTARE ANTI-DOPING**

**2021**

Maj, 2020

## PËRMBATJA

<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>Parimet themelore për Kodin dhe Rregullat Anti-Doping të KOK-ut</b> .....	<b>4</b>
<b>Programi Kombëtar Antidoping i KosADA</b> .....	<b>5</b>
<b>Fusha e aplikimit të Rregullave të Antidopingut</b> .....	<b>5</b>
<b>Neni 1 PËRKUFIZIMI I DOPINGUT</b> .....	<b>8</b>
<b>Neni 2 SHKELJET E RREGULLAVE TË ANTIDOPING</b> .....	<b>8</b>
<b>Neni 3 Prova e Dopingut</b> .....	<b>12</b>
<b>Neni 4 Prova e Dopingut</b> .....	<b>15</b>
<b>Neni 5 Analizat dhe hetimet</b> .....	<b>21</b>
<b>Neni 6 Analiza e Mostrave</b> .....	<b>27</b>
<b>Neni 7 Menaxhimi i rezultateve: Përgjegjësia, shqyrtimi fillestar, njoftimi dhe pezullimi i përkohshëm</b> .....	<b>29</b>
<b>NENI 8 Menaxhimi i rezultateve: E drejta për një seance të dëgjimore të drejtë dhe njoftimin e vendimit</b> .....	<b>34</b>
<b>Neni 9 Diskualifikimi automatik i rezultateve</b> .....	<b>37</b>
<b>Neni 10 Sanskionet për individët</b> .....	<b>37</b>
<b>Neni 11 Pasojat për ekipe</b> .....	<b>53</b>
<b>NENI 12 Sanksionet nga KosADA ndaj organeve të tjera sportive</b> .....	<b>53</b>
<b>NENI 13 Menaxhimi i rezultateve apelimi</b> .....	<b>55</b>
<b>NENI 14 Konfidencialiteti dhe raportimi</b> .....	<b>59</b>
<b>NENI 15 Zbatimi i vendimeve</b> .....	<b>65</b>
<b>NENI 16 Parashkrimi</b> .....	<b>67</b>
<b>NENI 17 Edukimi</b> .....	<b>67</b>
<b>NENI 18 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të federatave kombëtare</b> .....	<b>67</b>
<b>NENI 19 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të KosADA-s</b> .....	<b>69</b>
<b>NENI 20 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të sportistëve</b> .....	<b>70</b>
<b>NENI 21 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të personelit mbështetës të sportistëve</b> .....	<b>71</b>
<b>NENI 22 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të personave të tjerë që i nënshtrohen këtyre rregullave anti-doping</b> .....	<b>72</b>
<b>NENI 23 Interpretimi i kodit</b> .....	<b>72</b>
<b>NENI 24 Dispozitat përfundimtare</b> .....	<b>73</b>
<b>SHTOJCA 1 PËRKUFIZIMET</b> .....	<b>76</b>

## Hyrje

Kjo Rregullore është miratuar nga KosADA dhe është në pajtim me Kodin e Antidoping të WADA-s. Këto Rregulla synojnë fuqizimin e parimeve Antidoping në Republikën e Kosovës.

Kjo Rregullore përcakton rregulla sportive të cilat rregullojnë kushtet në të cilat zhvillohet sporti. Me qëllim të zbatimit të rregullave anti-doping në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë, këto rregulla janë të natyrës së ndryshme nga ligjet penale dhe civile. Kjo Rregullore nuk ka për qëllim t'i nënshtrohet ose të kufizohet nga ndonjë kërkesë kombëtare dhe standarde ligjore të zbatueshme për procedurat penale ose civile, megjithëse ato synojnë të zbatohen në një mënyrë që respekton parimet e proporcionalitetit dhe të drejtat e njeriut. Kur bëhet fjalë për respektimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, të gjitha gjykatat, gjykatat e arbitrazhit dhe organet e tjera gjyquese duhet të jenë të vetëdijshme dhe të respektojnë natyrën e veçantë të këtyre rregullave Anti-Doping, të cilat zbatojnë Kodin, dhe faktin që këto rregulla përfaqësojnë akterë të shumtë të sportit në të gjithë botën, prandaj është e nevojshme për të mbrojtur dhe siguruar një sport fair apo të drejtë.

Ashtu siç përcaktohet me Kodin e WADAs, KosADA do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha aspekteve të Kontrollit të Dopingut. Çdo aspekt i Kontrollit të Dopingut ose Edukimit të Anti-doping-ut mund të delegohet nga KosADA tek palët e tjera të deleguara, megjithatë, KosADA do t'i kërkojë nga këto palë të kryejë të gjitha punët dhe obligimet në përputhje me Kodin, Standardet Ndërkombëtare dhe këto rregullore për Anti-Doping. KosADA do të mbetet gjithmonë plotësisht përgjegjëse për të siguruar që çdo çështje e deleguar të kryhet në përputhje me Kodin e WADA. KosADA mund të delegojë përfaqësuesit e saj të menaxhimit të rezultateve në Gjykatën e Arbitrazhit Sportivë (KAS).

## **Parimet themelore për Kodin dhe Rregullat Anti-Doping të KOK-ut**

Programet e Anti-doping-ut janë të bazuara në vlerat kryesore e sportit e cila njihet si “fryma e sportit”: zhvillimi etik rreth përsosmërisë njerëzore dhe zhvillimit të talenteve natyrale të secilit *Sportist*.

Programet anti-doping synojnë të mbrojnë shëndetin e Sportistëve dhe t’u sigurojnë mundësinë atyre që të zhvillohen pa *Përdorimin e Substancave dhe Metodave të Ndalura*.

Këto programe poashtu synojnë që të ruajnë integritetin e sportit në drejtim të respektimit të rregullave, konkurrentëve të tjerë, konkurrencës së ndershme, fushës të barabartë të lojës dhe vlerës së sportit të pastër në botë.

Fryma e sportit është vlerësim i shpirtit, trupit dhe mendjes. Është thelbi i Olimpizmit, që reflektohet në vlerat që ne gjejmë tek sporti dhe nëpërmjet sportit, e të cilat përfshijnë:

- Shëndeti;
- Etika, loja e drejtë dhe ndershmëria;
- Të drejtat e sportistit siç përcaktohen në Kod;
- Ekselencia në rezultate;
- Karakteri dhe edukimi;
- Argëtimi dhe kënaqësia;
- Puna në ekip;
- Dedikimi dhe përkushtimi;
- Respektimi i rregullave dhe ligjeve;
- Respektimi i vetes dhe Pjesëmarrësve të tjerë;
- Kurajo;
- Komuniteti dhe solidariteti;

Fryma e sportit shprehet në mënyrën se si ne luajmë të vërtetë.

Dopingi është tërësisht në kundërshtim me frymën e sportit.

## **Programi Kombëtar Antidoping i KosADA**

KosADA është person juridik, regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurese, në formën e një organizatë jofitimprurëse (OJQ) përmes KOK me synim funksionimin si një Organizatë e pavarur kombëtare Antidoping në Kosovë, si e tillë, KosADA ka autoritetin dhe përgjegjësinë e nevojshme për të qenë e pavarur në aktivitetet dhe vendimet e saj nga institucionet e tjera publike dhe qeveria.

Pa kufizim, kjo përfshin ndalimin e çdo përfshirje në vendimet, punën ose aktivitetet e saj nga çdo person i cili në të njëjtën kohë është i përfshirë në menaxhimin e ndonjë Federate Ndërkombëtare, Federatës Kombëtare, Organizatës së Aktiviteve Madhore, Komitetit Olimpik Kombëtar, Komitetit Kombëtar Paralimpik, ose departamentit qeveritar me përgjegjësi për sportin ose anti-dopingun.

### **Fusha e aplikimit të Rregullave të Antidopingut**

Kjo rregullore për Antidoping duhet të aplikohet nga:

**a)** KosADA, përfshirë anëtarët e komitetit ekzekutiv të KOK, koordinatorin e KosADA, zyrtarët dhe punonjësit e caktuar si dhe palët e treta të deleguara dhe punonjësit e tyre, të cilët janë të përfshirë në çdo aspekt të Kontrollit të Dopingut;

**b)** Federatat Kombëtare Sportive, përfshirë anëtarët e bordit të tyre, drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e caktuar si dhe palët e treta të deleguara dhe punonjësit e tyre, të cilët janë të përfshirë në çdo aspekt të Kontrollit të Dopingut;

**c)** Sportistët (si më poshtë), personelin mbështetës të sportistëve dhe personat e tjerë (përfshirë personat e mbrojtur), në secilin rast, pavarësisht nëse një person i tillë është një shtetas ose qytetarë në Kosovë:

**(I)** Të gjithë sportistët dhe personeli mbështetës i sportistëve të cilët janë anëtarë ose mbajtës të licensave të ndonjë Federate Kombëtare të Kosovës (përfshirë klubet, ekipet, shoqatat ose ligat);

**(II)** Të gjithë sportistët dhe personeli mbështetës i sportistëve që marrin pjesë në gara dhe aktivitete të tjera të organizuara, të thirrura, të autorizuara ose të njohura nga ndonjë

Federatë Kombëtare ose nga ndonjë anëtar ose organizatë anëtare të ndonjë e ndonjë Federate Kombëtare (përfshirë klubet, ekipet, shoqatat ose ligat), kudo që mbahen;

**(III)** Çdo sportist tjetër ose person mbështetës i sportistit ose personit tjetër i cili, në bazë të një akreditimi, licence ose marrëveshje tjetër kontraktuale, i nënshtrohet autoritetit të ndonjë Federate kombëtare, ose të ndonjë anëtari ose organizate anëtare të çdo Federate Kombëtare në Kosovë (përfshirë klubet, ekipet, shoqatat ose ligat), për qëllime të anti-doping-ut; dhe

**(IV)** Të gjithë Sportistët dhe personeli i mbështetjes së sportistëve që marrin pjesë në çdo cilësi në çdo aktivitet të organizuar, mbajtur, thirrur ose autorizuar nga organizatori i një aktiviteti kombëtarë ose i një lige kombëtare që nuk është e lidhur me një Federatë Kombëtare.

**(V)** Sportistët rekreativë, d.m.th. çdo person që merret ose merr pjesë në aktivitete sportive ose të fitnesit për qëllime rekreative, por që ndryshe nuk do të garonte në gara ose aktivitete të organizuara, të njohura ose të organizuara nga një Federatë Kombëtare, ose nga ndonjë shoqatë, organizatë, event ndërkombëtare në një kategori të hapur ose nuk është përfshirë në ndonjë Regjistër Testimi ose informacione për vendndodhjet në listat e ndonjë Federatë Ndërkombëtare ose Organizatë Kombëtare Anti-Doping.

**(VI)** Të gjithë personat e tjerë mbi të cilët Kodi i jep autoritet KosADAs, duke përfshirë të gjithë sportistët që janë shtetas në Kosovë, dhe të gjithë sportistët të cilët janë rezidentë në Kosovë, qoftë për të konkurruar apo për t'u trajnuar ose ndryshe.

Secili person i lartëpërmendur konsiderohet, si një kusht i pjesëmarrjes ose përfshirjes së tij/saj në sport në Kosovë, se është pajtuar dhe është i detyruar të zbatojë këto Rregulla Anti-Doping dhe se njeh autoritetin e KosADA për t'i zbatuar këto Rregullat Anti-Doping, duke përfshirë çdo pasojë për shkeljen e tyre, dhe në juridiksionin e paneleve të dëgjimit të specifikuar në Nenin 8 dhe Nenin 13 për t'u dëgjuar dhe përcaktuar çështjet dhe ankesat e paraqitura nën këto Rregulla Anti-Doping.

Brenda grupit të përgjithshëm të sportistëve të përcaktuar më sipër, të cilët janë të detyruar dhe kërkohen të jenë në përputhje me këto Rregulla Anti-Doping, sportistët e mëposhtëm do të konsiderohen të jenë Sportistë të Nivelit Kombëtar për qëllimet e këtyre

Rregullave Anti- Doping, dhe, për këtë arsye, dispozitat specifike në këto Rregulla Anti-Doping të zbatueshme për Sportistët e Nivelit Kombëtar (p.sh. Testimi, TUE, vendndodhja dhe Menaxhimi i Rezultateve) do të zbatohen për sportistët si në vijim:

**(a)** Sportistët që janë anëtarë ose mbajtës të licencave të ndonjë Federate Kombëtare në Kosovë ose ndonjë organizate tjetër anëtare në një Federatë Kombëtare, duke përfshirë shoqatat, klubet, skuadrat ose ligat.

**(b)** Sportistët që marrin pjesë ose garojnë në çdo garë, event ose aktivitet, i cili organizohet, njihet ose organizohet nga një Federatë Kombëtare nga ndonjë anëtar, shoqatë, organizatë, klub, skuadër ose ligë ose e njohur nga Qeveria në Kosovë.

**(c)** Çdo sportistë tjetër që në bazë të një akreditimi, licence ose çfarëdo marrëveshje tjetër kontraktuale, bie në kompetencat e një Federate Kombëtare në Shqipëri ose të ndonjë anëtar, shoqatë, organizatë, klubi, skuadre ose liga të lidhur në Kosovë për qëllimet e luftimit të dopingut në sport në Kosovë.

**(d)** Sportistët që marrin pjesë në çdo aktivitet të organizuar, njohur ose pritur nga një organizator i ngjarjeve Kombëtare ose ndonjë ligë tjetër kombëtare dhe që nuk është e lidhur ndryshe me një Federatë Kombëtare.

Sidoqoftë, nëse ndonjë sportistë i lartëpërmendur konsiderohet nga Federatat përkatëse Ndërkombëtare si Sportistë i Nivelit Ndërkombëtar, atëherë ata do të konsiderohen të jenë Sportistë të Nivelit Ndërkombëtar (dhe jo sportistë të Nivelit Kombëtar) për qëllimet e këtyre Rregullave Anti-Doping.

## Neni 1 PËRKUFIZIMI I DOPINGUT

Dopingu përkufizohet si ndodhi e një ose më shumë shkeljeve të rregullave Antidoping të parashikuara nga Neni 2.1 deri në Nenin 2.11 të këtyre Rregullave Anti-Doping.

## Neni 2 SHKELJET E RREGULLAVE TË ANTIDOPING

Qëllimi i Nenit 2 është përcaktimi i rrethanave dhe sjelljes që përbëjnë shkelje të rregullit anti-doping. Shqyrtimet në çështjet e dopingut zhvillohen bazuar në prezumimin që janë shkelur një ose më shumë prej këtyre rregullave specifike.

Sportistët ose personat e tjerë janë përgjegjës që të kenë njohuri rreth asaj se çka është një shkelje e rregullit Antidoping dhe substancat dhe metodat që janë përfshirë në Listën e Ndaluar.

Konsiderohen si shkelje të rregullit Antidoping pikat si më poshtë:

### **2.1. Prania e një substance të ndaluar ose medikamenteve në mostrën e sportistit;**

**2.1.1.** Është obligim personal i çdo sportisti për të siguruar që asnjë substancë e ndaluar mos të futet në trupin e tij /saj. Sportistët janë përgjegjës për çdo substancë të ndaluar ose medikamenteve që gjenden të pranishëm në mostrat e tyre. Për pasojë, nuk është e nevojshme të demonstrohet paramendim, faj, neglizhencë apo përdorim me vetëdije nga ana e sportit për të provuar një shkelje Antidoping sipas Nenit 2.1.

**2.1.2.** Prova e mjaftueshme e një shkeljeje të rregullit Antidoping sipas Neni 2.1 realizohet si më poshtë: prania e një substance të ndaluar ose medikamenteve të ndaluara në mostrën A të sportistit ndërsa sportisti heq dorë nga analiza e mostrën B dhe mostra B nuk analizohet; ose, nëse mostra B e sportistit analizohet dhe analiza e mostra B e sportistit konfirmon praninë e substancës së ndaluar ose medikamenteve të tjera të ndaluara, që është gjetur në mostrën A të sportistit; ose, nëse mostra B e sportistit e ndarë në dy shishe dhe analiza e shishes së dytë konfirmon praninë e substancës së ndaluar ose medikamenteve të saj që gjenden në shishen e parë.



**2.1.3.** Përveç atyre substancave për të cilat është përcaktuar shprehimisht një prag sasior në Listën e Ndaluar, prania e një sasive të një substance të ndaluar ose medikamenteve të saj në një Mostër, sportisti përbën një shkelje të rregullit anti-doping.

**2.1.4.** Si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i Nenit 2.1, Lista e Ndaluar ose Standardet Ndërkombëtare ose Dokumentat Teknikë mund të vendosin kritere specifike për raportim ose vlerësimin e disa Substancave të Ndaluar.

## **2.2. Përdorimi ose tentimi i përdorimit nga një sportist i një substance apo metode të ndaluar;**

**2.2.1.** Është detyra personale e çdo sportisti të sigurojë që asnjë substancë e ndaluar të mos futet në trupin e tij ose të saj dhe të mos përdorë asnjë metodë e ndaluar. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të demonstrohet paramendimi, faji, neglizhenca ose përdorimi me vetëdije nga ana e sportistit për të provuar shkeljen e një rregulli Antidoping për përdorimin e një substance të ndaluar ose një metode të ndaluar.

**2.2.2.** Suksesit ose mos-suksesi i përdorimit ose tentativës së përdorimit të një substance të ndaluar ose metode të ndaluar nuk është përcaktuese. Është e mjaftueshme që substanca e ndaluar ose metoda e ndaluar të jetë përdorur ose të jetë tentuar për t'u përdorur për kryerjen e një shkeljeje të një rregulli anti-doping.

## **2.3. Shmangia, refuzimi ose mosdhënia e mostrës nga sportisti**

Shmangia e dhënies së mostrës ose refuzimi ose mospërmbushja e dhënies së mostrës pa justifikim bindës pas njoftimit nga një person i autorizuar.

## **2.4. Dështimet në lidhje me vendndodhjen**

Çdo kombinim i (3) tre analizave të pakryera dhe/ose mosparaqitja, sipas përcaktimit në standardin Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetime, brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore nga një sportist në një bazë të dhënash të regjistruar për analizat.

## **2.5. Manipulimi ose tentativa e manipulimit me një pjesë të kontrollit për Doping nga një sportist ose person tjetër**

## **2.6. Zotërimi i substancave të ndaluara dhe metodave të ndaluara nga një sportist ose person mbështetës i sportistit**

**2.6.1.** Zotërimi nga një sportistë gjatë garës i një substance të ndaluar ose i një metode të ndaluar, ose zotërimi nga një sportistë jashtë garës i një metode të ndaluar ose një substance të ndaluar që është e ndaluar jashtë garës, përveç kur sportisti provon që Zotërimi është në pajtim me një përjashtim për përdorim terapeutic ("TUE") të dhënë në pajtim me Nenin 4.4 ose një justifikim tjetër të pranueshëm.

**2.6.2.** Zotërimi nga një anëtar i personelit mbështetës të sportistit gjatë garës i një substance të ndaluar ose metode ta ndaluar, ose zotërimi nga një anëtar i personelit mbështetës të sportistit jashtë garës i një një substance të ndaluar ose metode të ndaluar që ndalohet jashtë garës në lidhje me një sportistë, garë ose trajnim, përveç kur anëtari i personelit mbështetës të sportistit provon që zotërimi është në pajtim me një TUE dhënë sportistit në përputhje me nenin 4.4 ose justifikime të tjera të arsyeshme.

## **2.7. Trafikimi ose tentative e trafikimit e një substance ose metode të ndaluar**

**2.8. Administrimi ose tentativa e administrimit nga një sportistë ose person tjetër gjatë garës tek një sportistë, të një substance të ndaluar ose metode të ndaluar ose administrimi apo tentative të administrimit nga çdo sportistë jashtë garës të një substance të ndaluar ose metode të ndaluar e cila është e ndaluar jashtë garës.**

## **2.9. Bashkëpunimi ose tentative e bashkëpunimit nga një sportistë ose person tjetër**

Ndihma, inkurajimi, mbështetja, lehtësimi, fshehja, mbulimi ose një lloj tjetër e bashkëpunimit me paramendim që përfshin shkeljen e një rregulli anti-doping, tentativa e shkeljes së një rregulli Antidoping ose shkeljen e Nenit 10.14.1 nga një person tjetër.

## **2.10. Marrëdhëniet e ndaluara nga një sportist ose person tjetër**

**2.10.1.** Marrëdhëniet e një sportisti ose të një personi tjetër që i nënshtrohet autoritetit të një organizate Antidoping në një cilësi profesionale ose sportive me një anëtar të personelit mbështetës të një sportisti i cili:

**2.10.1.1.** Nëse i nënshtrohet autoritetit të një organizate Anti-Doping, është brenda afatit të papërshtatshmërisë; ose

**2.10.1.2.** Nëse nuk i nënshtrohet autoritetit të një organizate Antidoping dhe nëse papërshtatshmëria nuk është trajtuar në një proces për menaxhimin e rezultateve sipas kodit, është dënuar ose konstatuar në një proces penal, disiplinor ose profesional të jetë përfshirë në një sjellje që do të përbënte shkelje të rregullave Antidoping nëse do të zbatoheshin rregullat në pajtim me kodin për këtë person. Statusi kualifikues i këtij personi mbetet në fuqi për periudhën që zgjat më shumë prej (6) gjashtë vjet nga vendimi penal, profesional disiplinor ose kohëzgjatja e sanksionit penal, disiplinor apo profesional të dhënë; ose

**2.10.1.3.** Po shërben si përfaqësues ose ndërmjetës për një individ të përshkruar në Nenin 2.10.1.1 ose 2.10.1.2.

**2.10.2.** Për të krijuar një shkelje të nenit 2.10, një organizatë Anti-Doping duhet të vendosë se sportisti ose personi tjetër e dinte statusin e diskualifikuar të personit mbështetës të sportistit. Barra do të jetë mbi sportistin ose një person tjetër për të vërtetuar që çdo lidhje me një person mbështetës të sportistit të përshkruar në nenin 2.10.1.1 ose 2.10.1.2 nuk është në një kapacitet profesional ose të lidhur me sportin dhe / ose se një lidhje e tillë nuk mund në mënyrë të arsyeshme të ishte shmangur.

Organizatrat Anti-Doping që janë në dijeni të personelit mbështetës të sportistëve që plotësojnë kriteret e përshkruara në Nenin 2.10.1.1, 2.10.1.2 ose 2.10.1.3 do t'ia paraqesin këto informacione WADA- s.

## **2.11. Veprimet nga një sportist ose një person tjetër për të dekurajuar ose hakmarrë kundër raportimit tek autoritetet**

Kur një sjellje e tillë nuk përbën ndryshe shkelje të Nenit 2.5:

**2.11.1.** Çdo veprim që kërcënon ose kërkon të frikësojë një person tjetër me qëllim të dekurajimit të personit nga raportimi me mirëbesim i informacionit që lidhet me një shkelje të pretenduar të rregullit anti-doping ose pretendim të mosrespektimit të kodit të WADA-s, një organizata Anti-Doping, organi i zbatimit të ligjit, rregullatori ose organi disiplinor profesional, organi i dëgjimit ose personi që kryen një hetim për WADA ose një organizatë Anti-Doping.

**2.11.2.** Hakmarrja ndaj një personi i cili, me mirëbesim, ka siguruar prova ose informacione që lidhen me një shkelje të pretenduar të rregullit anti-doping ose pretendim të mosrespektimit të kodit për WADA, një organizatë Anti-Doping, organi i zbatimit të ligjit, rregullatori ose organi disiplinor profesional, organi i dëgjimit ose personi që kryen një hetim për WADA ose një organizatë Anti-Doping.

Për qëllime të nenit 2.11, hakmarrja, kërcënimi dhe frikësimi përfshijnë një veprim të ndërmarrë kundër një personi të tillë ose sepse veprimi nuk ka një bazë të mirëbesimit ose është një përgjigje disproporcionale.

### **Neni 3 Prova e Dopingut**

#### **3.1. Barra dhe standardet e provës**

KosADA ka barrën të vërtetë që ka ndodhur një shkelje e rregullit anti-doping. Standardi i provës është nëse një organizatë Antidoping ka provuar një shkelje të rregullit Antidoping lehtësisht të pranueshme nga paneli gjykues duke patur parasysh seriozitetin e dyshimit të ngritur. Ky standard prove është në të gjitha rastet më i madh se thjesht një peshim mundësie, por më pak se një provë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nëse kodi ia cakton barrën e proves sportistit ose personit tjetër, që dyshohet se ka kryer një shkelje antidoping, për të hedhur poshtë një supozim ose për të provuar fakte ose rrethana të caktuara, standardi i provës bëhet përmes balancit të mundësisë, përveç siç parashikohet në nenet 3.2.2 dhe 3.2.3, standardi i provës do të jetë një bilanc i probabilitetit.

### **3.2. Metodatat për të provuar faktet dhe prezumimet**

Faktet në lidhje me shkeljet e rregullit Antidoping mund të provohen me çdo mjet të besueshëm, duke përfshirë pranimet.

Rregullat e mëposhtme të provës zbatohen për çështjet e dopingut:

**3.2.1.** Metodatat analitike ose limitet e vendimeve të aprovuara nga WADA pas konsultimeve brenda komunitetit përkatës shkencor dhe që janë objekt i ekspertizës prezumohet të jenë shkencërisht të vlefshme. Sportisti ose personi tjetër që kërkon ta kundërshtojë këtë prezumim të vlefshmërisë shkencore, si parakusht për një kundërshtim të tillë, fillimisht njofton WADA-n për kundërshtimin dhe bazën e kundërshtimit. KAS, me iniciativën e vet, mund të njoftojë gjithashtu WADA-n në lidhje me këtë ndryshim. Me kërkesë të WADA-s, paneli i KAS-it cakton një ekspert të përshtatshëm shkencor për të asistuar panelin në vlerësimin e kundërshtimit. Brenda 10 ditëve nga marrja e një njoftimi të tillë nga WADA dhe nga marrja e dosjes së KAS-it nga WADA, kjo e fundit ka gjithashtu të drejtën të ndërhyjë si palë, të paraqitet si amicus curiae ose ndryshe të paraqesë prova në këtë proces. Në rastet para KAS, me kërkesë të WADA, paneli KAS do të caktojë një ekspert të duhur shkencor për të ndihmuar panelin në vlerësimin e kësaj kundërshtie.

**3.2.2.** Laboratorët e akredituar nga WADA dhe laboratorët e tjerë të aprovuar nga WADA prezumohet të kenë zhvilluar analizë mostrash dhe procedura ruajtjeje në pajtim me standardin ndërkombëtar për laboratorët. Sportisti ose personi tjetër mund ta kundërshtojë këtë prezumim duke vërtetuar që ka ndodhur një shmangie nga standardi ndërkombëtar për laboratorët i cili normalisht ka shkaktuar konstatimin anormal të analizave. Nëse sportisti ose personi tjetër e kundërshton prezumimin e mësipërm duke treguar që ka ndodhur një shmangie nga standardi ndërkombëtar për laboratorët i cili normalisht mund të ketë shkaktuar konstatimin anormal të analizave, organizata Antidoping ka barrën të vërtetojë që kjo shmangie nuk ka shkaktuar konstatimin anormal të analizave.

**3.2.3.** Devijimet nga ndonjë standard ndërkombëtar ose rregull ose politikë tjetër anti-doping e përcaktuar në Kod ose këto rregulla Anti-Doping nuk do të zhvlerësojnë rezultatet analitike ose prova të tjera të shkeljes së rregullit anti-doping dhe nuk do të përbëjnë mbrojtje ndaj një shkelje të rregullit antidoping, me kusht se, nëse sportisti ose

personi tjetër vërteton se një largim nga një prej dispozitave specifike të standardit ndërkombëtar të renditur më poshtë mund të ketë shkaktuar një shkelje të rregullit anti-doping bazuar në një konstatim anormal të analizave ose dështim të vendndodhjes, atëherë KosADA do të ketë barrën për të vërtetuar se një largim i tillë nuk shkaktoi konstatim anormal të analizave ose dështimin e vendndodhjes:

**(I)** Një largim nga standardi ndërkombëtar për testimin dhe hetimet në lidhje me mbledhjen e mostrës ose trajtimin e mostrës i cili në mënyrë të arsyeshme mund të ketë shkaktuar një shkelje të rregullit anti-doping bazuar në një konstatim anormal të analizave, në këtë rast KosADA do të ketë barrën për të vërtetuar se një largim i tillë nuk shkaktoi konstatim anormal të analizave;

**(II)** Një largim nga standardi ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve ose standardi ndërkombëtar për testimin dhe hetimet në lidhje me një konstatim anormal të pasaportës që mund të ketë shkaktuar një shkelje të rregullit anti-doping, në këtë rast KosADA do të ketë barrën për të vërtetuar se largimi nuk shkaktoi shkeljen e rregullit anti-doping;

**(III)** Një largim nga standardi ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve në lidhje me kërkesën për t'i dhënë njoftim sportistit për hapjen e mostrës B i cili në mënyrë të arsyeshme mund të ketë shkaktuar një shkelje të rregullave anti-doping bazuar në një konstatim anormal të analizave, në këtë rast KosADA do të ketë barrën për të vërtetuar se një largim i tillë nuk ka shkaktuar konstatim anormal të analizave;

**(IV)** Një largim nga standardi ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve në lidhje me njoftimin e sportistit, i cili në mënyrë të arsyeshme mund të ketë shkaktuar një shkelje të rregullit anti-doping bazuar në një dështim të vendndodhjes, në këtë rast KosADA do të ketë barrën për të vërtetuar se një largim i tillë nuk ka shkaktuar dështimi i vendndodhjes.

**3.2.4.** Faktet e provuara nga një vendim gjykate ose tribunali disiplinor profesional me juridiksion kompetent që nuk janë objekt i një ankimi në shqyrtim e sipër janë prova të pakundërshtueshme kundër sportistit ose personit tjetër të cilit i takon vendimi për ato fakte, përveç kur sportisti ose personi tjetër provon që vendimi ka shkelur parimet e drejtësisë.

**3.2.5.** Paneli i gjykimit në një seancë dëgjimi, në lidhje me shkeljen e një rregulli Antidoping mund të nxjerrë një përfundim në disfavor të sportistit ose personit tjetër që mendohet të ketë kryer një shkelje të rregullit Antidoping bazuar në refuzimin e sportistit ose personit tjetër, pas një kërkesë të bërë në një kohë të arsyeshme para seancës, për t'u paraqitur në seancë (personalisht ose në telefon, sipas udhëzimit të panelit gjykues) dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të panelit gjykues ose KosADAs që pretendon shkeljen e rregullit anti-doping.

## **Neni 4 Prova e Dopingut**

### **4.1. Përfshirja e listës së ndaluar**

Këto rregulla Antidoping përfshijnë Listën e Ndaluar që publikohet dhe rishikohet nga WADA sipas përshkrimit në Nenin 4.1 të Kodit.

Përveç nëse parashikohet ndryshe në Listën e Ndaluar ose një rishikim, Lista e Ndaluar dhe rishikimet do të hyjnë në fuqi sipas këtyre Rregullave Anti-Doping tre (3) muaj pas botimit nga WADA pa kërkuar ndonjë veprim të mëtejshëm nga KosADA. Të gjithë sportistët dhe personat e tjerë do të jenë të detyruar nga Lista e Ndaluar, dhe çdo rishikim i saj, nga data e hyrjes në fuqi, pa formalitete të mëtejshme. Është përgjegjësi e të gjithë sportistëve dhe personave të tjerë të familjarizohen me versionin më të azhurnuar të Listës së Ndaluar dhe të gjitha rishikimet e saj.

### **4.2. Substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara të identifikuar në Listën e Ndaluar**

#### **4.2.1. Substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara**

Lista e Ndaluar do të identifikojë ato substanca të ndaluara dhe metodat e ndaluara të cilat janë të ndaluara si doping në çdo kohë (si në garë ashtu edhe jashtë garës) për shkak të potencialit të tyre për të rritur performancën në konkurrimet e ardhshme ose potencialin e tyre të maskimit, dhe ato substanca dhe metodat të cilat janë të ndaluara vetëm në garë. Lista e Ndaluar mund të zgjerohet nga WADA për një sport të veçantë. Substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara mund të përfshihen në Listën e Ndaluar

sipas kategorisë së përgjithshme (p.sh., agjentët anabolikë) ose duke iu referuar specifikava të një substance ose metode të veçantë. Përveç kur parashikohet ndryshe në Listën e Ndaluar dhe/ose në një rishikim, Lista e Ndaluar dhe rishikimet hyjnë në fuqi në bazë të këtyre Rregullave Antidoping tre muaj pas publikimit nga WADA pa kërkuar ndonjë veprim tjetër nga KosADA. Të gjithë sportistët dhe personat e tjerë l nënshtrohen Listës së Ndaluar dhe çdo rishikimi të saj nga data që ato hyjnë në fuqi pa formalitete të mëtejshme. Është përgjegjësia e të gjithë sportistëve dhe personave të tjerë të familjarizohen me versionin më të përditësuar të Listës së Ndaluar dhe të gjitha rishikimet e saj.

#### **4.2.2. Substanca të Specifikuara ose Metoda të Specifikuara**

Për qëllime të zbatimit të Nenit 10, të gjitha substancat e ndaluara janë substanca të specifikuara, përveç atyre të identifikuara në listën e ndaluar. Asnjë metodë e ndaluar nuk do të jetë një metodë e specifikuar, përveç nëse identifikohet specifikisht si një metodë e specifikuar në listen e ndaluar.

#### **4.2.3. Substancat abuzive**

Për qëllime të zbatimit të Nenit 10, substancat abuzive do të përfshihen në këto substanca të ndaluara që specifikohen specifikisht si substanca abuzive në Listën e Ndaluar, sepse me ato abuzohet shpesh në shoqëri jashtë kontekstit të sportit.

### **4.3. Përfundimi i WADA-s për Listën e Ndaluar**

Përfundimi i WADA-s për substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara që do të përfshihen në Listën e Ndaluar dhe klasifikimi i substancave në kategori në Listën e Ndaluar, dhe klasifikimi i një substance si tërësisht e ndaluar ose vetëm gjatë garës, klasifikimi i një substance ose metode si substancë e specifikuar, metodë e specifikuar ose substancë abuzimi është përfundimtare dhe nuk i nënshtrohet kundërshtimit nga një sportist ose person tjetër bazuar mbi argumentin që substanca ose metoda nuk ishte agjent fshehës ose nuk kishte potencialin për të rritur rezultatin, të përbënte rrezik për shëndetin ose të shkelte frymën e sportit.



#### **4.4. Përjashtimet e Përdorimit Terapeutik (“TUEs”)**

**4.4.1.** Prania e një substance të ndaluar ose medikamenteve, dhe/ose përdorimi ose tentativa e përdorimit, zotërimi ose administrimi apo tentativa e administrimit të një substance të ndaluar ose metode të ndaluar nuk konsiderohet shkelje e rregullit Antidoping nëse kjo është në pajtim me dispozitat e një TUE të dhënë në pajtim me standardin ndërkombëtar për përjashtimet për përdorim terapeutik.

#### **4.4.2. Procesi i aplikimit të TUEs**

**4.4.2.1.** Çdo sportist që nuk është një sportist i nivelit ndërkombëtar do të aplikojë pranë KosADA për një TUE sa më shpejt që është e mundur, përveç kur zbatohen Nenet 4.1 ose 4.3 të standardit ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik. Aplikimi do të bëhet në përputhje me nenin 6 të standardit ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik siç postohet në faqen e internetit të KosADA ose Ministrisë përgjegjëse për sportin dhe dërguar në adresën elektronike [info@kos-ada.org](mailto:info@kos-ada.org).

**4.4.2.2.** KosADA do të krijojë një panel (Komisioni i përjashtimit të përdorimit terapeutik) për të shqyrtuar aplikimet për dhënien e TUE në përputhje me Nenin 4.4.2.2 (a) - (d) më poshtë:

**a)** Komisioni do të përbëhet nga një kryetar dhe [katër (4)] anëtarë të tjerë me përvojë në kujdesin dhe trajtimin e sportistëve dhe njohuri të shëndosha të mjekësisë klinike, sportive dhe ushtrimeve. Secili anëtar i emëruar do të shërbejë për një mandat prej katër (4) vjet.

**b)** Para se të shërbejë si anëtar i komisionit për TUE, secili anëtar duhet të nënshkruajë një deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe konfidencialitetit.

Anëtarët e emëruar nuk do të jenë punonjës të KosADA.

**c)** Kur bëhet një kërkesë në KosADA për dhënien e një TUE, kryetari i komisionit të TUE emëron tre (3) anëtarë (të cilët mund të përfshijnë kryetarin për të shqyrtuar aplikimin).

**d)** Para se të shqyrtohet një aplikim i TUE, secili anëtar duhet t'i paraqes kryetarit çdo rrethanë që mund të ndikojë në paanësinë e tyre në lidhje me sportistin që bën aplikimin. Nëse një anëtar i caktuar nga kryetari për të shqyrtuar një aplikim nuk është i gatshëm ose i paaftë për të vlerësuar aplikimin TUE të sportistit, për ndonjë arsye, kryetari mund

të caktojë një zëvendësues ose të caktojë një grup të ri (p.sh., nga grupi i paracaktuar I kandidatëve). Kryetari nuk mund të shërbejë si anëtar i komitetit nëse ka ndonjë rrethanë që ka të ngjarë të ndikojë në paanësinë e vendimit të TUE.

**4.4.2.3.** Komisioni i TUEs vlerëson dhe vendos menjëherë mbi aplikimin në përputhje me dispozitat përkatëse të standardit ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik dhe zakonisht (d.m.th. nëse nuk zbatohen rrethana të jashtëzakonshme) brenda jo më shumë se njëzet e një (21) ditësh nga data e marrjes të një aplikimi të plotë. Kur aplikimi është bërë në një kohë të arsyeshme para një eventi, komisioni duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të nxjerrë vendimin e tij para fillimit të eventit.

**4.4.2.4.** Vendimi i komisionit të TUE do të jetë vendimi përfundimtar i KosADA dhe mund të apelohej në përputhje me nenin 4.4.6. Vendimi i komitetit të TUE të KosADA do t'i njoftohet me shkrim Sportistit dhe WADA dhe organizatave të tjera Anti-Doping në përputhje me standardin ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik. Ai gjithashtu do të raportohet menjëherë në ADAMS.

#### **4.4.3. Aplikimi për TUE prapavepruese**

Nëse KosADA zgjedh t'i bëjë analizat një sportisti i cili nuk është sportist i nivelit Ndërkombëtar apo i nivelit Kombëtar, KosADA e lejon sportistin të bëjë kërkesë për një TUE prapavepruese për çdo substancë të ndaluar ose metodë të ndaluar që ai/ajo përdor për shkaqe terapeutike.

#### **4.4.4. Aprovim i TUE**

Një TUE e dhënë nga KosADA është e vlefshme në çdo nivel kombëtar në çdo vend dhe nuk ka nevojë të njihet zyrtarisht nga ndonjë organizatë tjetër kombëtare Anti-Doping. Sidoqoftë, nuk është e vlefshme automatikisht nëse sportisti bëhet një sportist i nivelit ndërkombëtar ose garon në një event ndërkombëtar, përveç nëse njihet nga Federata Ndërkombëtare përkatëse ose Organizata e Aktiviteteve Madhore në përputhje me standardin ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik si më poshtë:

**4.4.4.1.** Kur sportisti tashmë ka një TUE të dhënë nga KosADA për substancën ose metodën në fjalë, përveç nëse TUE e tyre do të njihet automatikisht nga Federata Ndërkombëtare ose Organizata e Aktiviteteve Madhore, sportistët do të aplikojnë në Federatën e tyre Ndërkombëtare ose tek kryetari i organizatës së Aktiviteteve Madhore për të njohur atë TUE. Nëse ajo TUE plotëson kriteret e përcaktuara në Standardin Ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik, atëherë Federata Ndërkombëtare ose Organizata e Aktiviteteve Madhore duhet ta njohë atë. Nëse Federata Ndërkombëtare ose Organizata e Aktiviteteve Madhore konsideron që TUE e dhënë nga KosADA nuk i plotëson ato kriteret dhe kështu refuzon ta njohë atë, Federata Ndërkombëtare do të njoftojë menjëherë sportistin dhe KosADAn duke e arsyetuar atë. Sportisti dhe / ose KosADA do të kenë njëzet e një (21) ditë nga njoftimi i tillë për ta referuar çështjen në WADA për shqyrtim në përputhje me nenin 4.4.6. Nëse çështja i referohet WADA për shqyrtim në përputhje me Nenin 4.4.6, TUE e dhënë nga KosADA mbetet e vlefshme për testimin në nivelin kombëtar gjatë dhe jashtë garave (por nuk është e vlefshme për aktivitetet e nivelit ndërkombëtar) në pritje të vendimit të WADA. Nëse çështja nuk i referohet WADA-s për rishikim brenda afatit njëzet e një (21) ditësh, KosADA duhet të përcaktojë nëse TUE origjinale që ajo dha megjithatë duhet të mbetet e vlefshme për testimin në nivel kombëtar gjatë dhe jashtë garave (që është dhënë që sportisti të pushojë së qeni një sportist i nivelit ndërkombëtar dhe të mos marrë pjesë në gara të nivelit ndërkombëtar). Në pritje të vendimit të KosADA, TUE mbetet e vlefshme për testimin në nivel kombëtar gjatë dhe jashtë garave (por nuk është e vlefshme për aktivitetet e nivelit ndërkombëtar)

**4.4.4.2.** Nëse sportisti nuk ka një TUE të dhënë nga KosADA për substancën ose metodën në fjalë, sportisti duhet të aplikojë direkt në Federatën Ndërkombëtare për një TUE në përputhje me procesin e përcaktuar në Standardin Ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik sa më shpejt ndërsa paraqitet nevoja. Nëse Federata Ndërkombëtare refuzon aplikimin e sportistit, ajo do të njoftojë sportistin menjëherë, duke e arsyetuar. Nëse Federata Ndërkombëtare miraton aplikimin e sportistit, ajo do të njoftojë sportistin dhe KosADA. Nëse KosADA konsideron që TUE e dhënë nga Federata Ndërkombëtare nuk plotëson kriteret e përcaktuara në standardin ndërkombëtar për përjashtimet e përdorimit terapeutik, ai ka njëzet e një (21) ditë nga njoftimi i tillë për ta

referuar çështjen në WADA për shqyrtim. Nëse KosADA i referon çështjen WADA për shqyrtim, TUE e dhënë nga Federata Ndërkombëtare mbetet e vlefshme për testim brenda dhe jashtë garës të nivelit ndërkombëtar (por nuk është i vlefshëm për gara të nivelit kombëtar) në pritje të vendimit të WADA. Nëse KosADA nuk e referon çështjen në WADA për shqyrtim, TUE e dhënë nga Federata Ndërkombëtare bëhet e vlefshme për garat e nivelit kombëtar gjithashtu kur skadon afati i shqyrtimit njëzet e një (21) ditësh.

#### **4.4.5. Skadimi, shfuqizimi, tërheqja dhe anulimi i një TUE-je**

**4.4.5.1.** Një TUE i dhënë në pajtim me këto Rregulla Anti-Doping: (a) skadon automatikisht në fund të çdo afati për të cilin është dhënë, pa qenë e nevojshme të bëhet ndonjë njoftim apo formalitet tjetër; (b) mund të shfuqizohet nëse sportisti nuk përmbush menjëherë kërkesat ose kushtet e vendosura nga komisioni TUE me lëshimin e TUE-s; (c) mund të tërhiqet nga komisioni TUE nëse më vonë vendoset që kriteret për dhënien e TUE-s faktikisht nuk përmbushen; ose (d) mund të anulohet pas rishikimit të WADA-s ose me ankim.

**4.4.5.2.** Në një rast të tillë, sportisti nuk i nënshtrohet asnjë pasoje bazuar në përdorimin ose zotërimin e tij/saj ose administrimin e substancës së ndaluar ose metodës së ndaluar në fjalë në pajtim me TUE-n para datës faktike të skadimit, shfuqizimit, tërheqjes ose anulimit të TUE-s. Rishikimi në pajtim me Nenin 5.1.1.1 të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të rezultateve të një konstatimi analitik anormal përfshin shqyrtimin nëse një konstatim i tillë është në pajtim me përdorimin e substancës së ndaluar ose metodës së ndaluar para asaj date, aktivitet në të cilën nuk konfirmohet asnjë shkelje rregulli anti-doping.

#### **4.4.6. Rishikimet dhe ankimimet e vendimeve për TUE**

**4.4.6.1.** Nëse KosADA refuzon një kërkesë për TUE, sportisti mund të bëjë ekskluzivisht ankim tek një organ ankimi i nivelit kombëtar i përshkruar në Nenet 13.2.2 dhe 13.2.3.

**4.4.6.2.** WADA rishikon çdo vendim të një Federate Ndërkombëtare për mosnjohjen e një TUE-je të dhënë nga KosADA që i referohet WADA-s nga sportisti ose KosADA. Përveç

kësaj, WADA rishikon çdo vendim të një Federate Ndërkombëtare për dhënien e një TUE që i referohet WADA-s nga KosADA. WADA mund të rishikojë çdo vendim tjetër TUE në çdo kohë, me kërkesë të personave të prekur ose kryesisht. Nëse një vendim TUE që rishikohet përmbush kriteret e përcaktuara në standardin ndërkombëtar për përjashtimet për përdorim terapeutik, WADA nuk ndërhyr. Nëse vendimi TUE nuk i përmbush ato kritere, WADA e anulon atë.

**4.4.6.3.** Një vendim TUE i një Federate Ndërkombëtare (ose i KosADA ku ky ka rënë dakord për të shqyrtuar kërkesën në emër të një Federate Ndërkombëtare) që nuk rishikohet nga WADA, ose që rishikohet nga WADA por nuk anulohet pas rishikimit, mund të ankimohet nga Sportisti dhe/ose KosADA ekskluzivisht tek KAS.

**4.4.6.4.** Një vendim i WADA-s për anulimin e një vendimi TUE mund të ankimohet nga sportisti, KosADA dhe/ose Federata Ndërkombëtare e interesuar vetëm tek KAS-i.

**4.4.6.5.** Mosmarrja e masave në një afat të arsyeshëm pas një kërkesë të bërë rregullisht për njohjen e një TUE-je ose për rishikimin e një vendimi TUE konsiderohet si refuzim i kërkesës, duke shkaktuar kështu të drejtat e zbatueshme të rishikimit / apelimit.

## **Neni 5 Analizat dhe hetimet**

### **5.1. Qëllimi i analizave dhe hetimeve**

**5.1.1.** Testimi dhe hetimet ndërmerren vetëm për qëllime anti-doping. Ato zhvillohen në pajtim me dispozitat e standardit ndërkombëtar për testimin dhe hetimet.

**5.1.2.** Testimi do të ndërmerret për të marrë prova analitike nëse sportisti ka shkelur Nenin 2.1 (Prania e një substancë të ndaluar ose metabolitet ose shënuesit e saj në mostrën e një sportisti) ose Nenin 2.2 (Përdorimi ose tentativa e përdorimit nga një sportist të një substance ose metode të ndaluar).

### **5.2. Autoriteti për të zhvilluar testime**

**5.2.1.** Në varësi të kufizimeve për testimin për aktivitetet e përcaktuara në Nenin 5.3, KosADA do të ketë autoritetin e testimit në garë dhe jashtë garës mbi të gjithë sportistët

e specifikuar në hyrjen e këtyre Rregullave Anti-Doping (Seksioni “Fusha e këtyre Rregullave Anti-Doping”).

**5.2.2.** KosADA mund të kërkojë nga çdo sportist mbi të cilin ka autoritetin e testimit (përfshirë çdo sportist që shërben për një periudhë të papërshtatshmërisë) të sigurojë një mostër në çdo kohë dhe në çdo vend.

**5.2.3.** WADA do të ketë autoritetin e testimit në garë dhe jashtë garës, siç parashikohet në Nenin 20.7.10 të kodit.

**5.2.4.** Nëse një Federatë Ndërkombëtare ose Organizatë e Aktiviteteve Madhore delegon ose kontraktin KosADAn për një pjesë të analizave (drejtpërdrejt ose nëpërmjet federatës kombëtare), KosADA mund të mbledhë mostra shtesë ose të udhëzojë laboratorin të kryejë analiza shtesë me shpenzimet e KosADA. Nëse mbledhen mostra shtesë ose kryhen tipe shtesë të analizave, njoftohet Federata Ndërkombëtare ose Organizata e Aktiviteteve Madhore.

### **5.3. Testime gjatë Aktivitetit**

**5.3.1.** Përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 5.3 të kodit, vetëm një organizatë e vetme duhet të jetë përgjegjëse për fillimin dhe drejtimin e testeve në vendin e aktivitetit gjatë një periudhe aktiviteti. Në aktivitetet ndërkombëtare që zhvillohen në Kosovë, mbledhja e mostrave fillohet dhe drejtohet nga Federata Ndërkombëtare (ose një organizatë tjetër ndërkombëtare që është organi vendim- marrës për atë Aktivitet). Në Aktivitetet Kombëtare që zhvillohen në Kosovë, mbledhja e mostrave fillohet dhe drejtohet nga KosADA. Me kërkesë të KosADA (ose organit vendim-marrës për atë aktivitet), çdo testim gjatë periudhës së aktivitetit jashtë vendit të aktivitetit, bashkërendohet me KosADA (ose organin përkatës vendim-marrës).

**5.3.2.** Nëse një organizatë Antidoping që përndryshe do të kishte autoritetin për teste, por nuk është përgjegjëse për fillimin dhe drejtimin e testeve në aktivitete, dëshiron të zhvillojë teste për sportistët në vendet e aktivitetit gjatë periudhës së aktivitetit, organizata Antidoping merr në fillim kontakt me KosADA (ose organin vendim-marrës të këtij aktiviteti) për të marrë leje për zhvillimin dhe bashkërendimin e këtyre analizave.

Nëse organizata Antidoping nuk është e bindur me përgjigjen nga KosADA (ose organi vendim-marrës I aktivitetit), organizata Antidoping mund t'i kërkojë WADA-s leje për zhvillimin e testimeve dhe për të përcaktuar si të bashkërendohen këto testime, në pajtim me procedurat e parashikuara në standardin ndërkombëtar për testim dhe hetimet. WADA nuk e jep aprovimin për këto testime para konsultimit dhe informimit të KosADA (ose organit vendim-marrës të aktivitetit). Vendimi i WADAs është përfundimtar dhe nuk ankimohet. Përveç kur parashikohet ndryshe në autorizimin për zhvillimin e testimeve, këto testime konsiderohen testime jashtë-garës. Menaxhimi i rezultateve për këto analiza është përgjegjësi e organizatës Antidoping që fillon analizat përveç kur parashikohet ndryshe në rregullat e organit vendim-marrës të aktivitetit.

#### **5.4. Kërkesat e testimeve**

**5.4.1.** KosADA do të kryejë planifikimin e shpërndarjes së testimeve, siç kërkohet nga standardi ndërkombëtar për testimin dhe hetimet.

**5.4.2.** Nëse normalisht është e arsyeshme, testimi do të koordinohet përmes ADAMS në mënyrë që të maksimizohet efektiviteti i përpjekjes së kombinuar të testimit dhe të shmanget testimi i panevojshëm i përsëritur.

#### **5.5. Informacion mbi Vendndodhjen e Sportistëve**

**5.5.1.** KosADA identifikon një listë të regjistruar për testim të atyre sportistëve që kërkohet të jenë në pajtim me kërkesat e vendndodhjes të standardit ndërkombëtar për testimin dhe hetimet dhe kush do t'i nënshtrohet pasojave për shkeljet e nenit 2.4 siç parashikohet në nenin 10.3.2. KosADA do të koordinojë me Federatat Ndërkombëtare për të identifikuar sportistë të tillë dhe për të mbledhur informacionin e vendndodhjes së tyre.

**5.5.2.** KosADA ofron nëpërmjet ADAMS-it një listë që identifikon ata sportistë të përfshirë në listën e regjistruar për testim me emër. KosADA do të rishikojë dhe përditësojë rregullisht, kur është e nevojshme, kriteret e tij për përfshirjen e sportistëve në listën e regjistruar për testim dhe do të rishikojë në mënyrë periodike (por jo më pak se tremujore) listën e sportistëve në listën e regjistruar për testim për të siguruar që secili sportist i listuar

të vazhdojë të plotësojë kriteret përkatëse. Sportistët do të njoftohen para se të përfshihen në listën e regjistruar për testim dhe kur të largohen nga ajo listë. Njoftimi do të përmbajë informacionin e përcaktuar në standardin ndërkombëtar për testimin dhe hetimet.

**5.5.3.** Kur një sportist përfshihet në një listë ndërkombëtare të regjistruar të testimit nga Federata e tyre Ndërkombëtare dhe në një listë kombëtare të regjistruar të testimit nga KosADA, KosADA dhe Federata Ndërkombëtare do të bien dakord ndërmjet tyre se cili prej tyre do të pranojë që të regjistrojë vendndodhjen e sportistit; në asnjë rast nuk do të kërkohet nga një sportist të bëjë regjistrimet e vendndodhjes në më shumë se një prej tyre.

**5.5.4.** Në përputhje me standardin ndërkombëtar për testimin dhe hetimet, secili sportist në listën e regjistruar të testimit do të bëjë sa vijon: (a) njofton KosADA për vendndodhjen e tij / saj në bazë tremujore; (b) përditëson atë informacion sipas nevojës, në mënyrë që të mbetet i saktë dhe i plotë në çdo kohë; dhe (c) vendos veten në dispozicion për testim në vendndodhjet e tilla.

**5.5.5.** Për qëllime të Nenit 2.4, mospërbushja e kërkesave nga sportisti sipas standardit ndërkombëtar për testimin dhe hetime do të konsiderohet si mos-depozitim ose një test i humbur, siç përcaktohet në aneksin B të standardit ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve, ku plotësohen kushtet e përcaktuara në shtojcën B.

**5.5.6.** Një sportist në listën e regjistruar për testim të KOSADA -së vazhdon të mbetet nën detyrimin e përmbushjes së kërkesave të vendndodhjes të standardit ndërkombëtar për testimin dhe hetimet, përveç kur dhe derisa (a) sportisti të bëjë njoftim me shkrim për KosADA që ai/ajo është tërhequr ose (b) KosADA ka vënë atë në dijeni që ai/ajo nuk vazhdon të përmbushë kriteret për përfshirje në listën e regjistruar për testim të KosADA -së.

**5.5.7.** Vendndodhja e informacionit e siguruar nga një sportist ndërsa është në listën e regjistruar për testim do të jetë e aksesueshme përmes ADAMS nga WADA dhe nga organizatat e tjera Anti-Doping që kanë autoritetin për të testuar atë sportistët siç parashikohet në Nenin 5.2. Vendndodhja e informacionit do të ruhet në konfidencialitet të plotë në çdo kohë; do të përdoret ekskluzivisht për qëllime të planifikimit, koordinimit ose



kryerjes së kontrollit të Dopingut, duke siguruar informacione të rëndësishme për pasaportën biologjike të s ose rezultate të tjera analitike, për të sportistit mbështetur një hetim mbi një shkelje të mundshme të rregullave anti-doping, ose për të mbështetur procedurat që pretendojnë një shkelje të rregullave antidoping; dhe do të shkatërrohet pasi nuk është më e rëndësishme për këto qëllime në përputhje me standardin ndërkombëtar për mbrojtjen e privatësisë dhe informacionit personal.

**(a)** Periudha gjashtë (6) mujore e papranueshmërisë; ose

**(b)** Periudha e papranueshmërisë në intervalin midis:

**(i)** Shumës së periudhës së papranueshmërisë të shqiptuar si masë për shkeljen e parë të rregullit anti-doping plus periudha e papranueshmërisë, që përndryshe vlen për shkeljen e dytë të rregullit antidoping, që trajtohet si të ishte shkelje e parë, dhe

**(ii)** dyfishi i periudhës së papranueshmërisë, që vlen si masë për shkeljen e dytë të rregullit anti-doping, e trajtuar sikur të ishte shkelje e parë.

Periudha e papranueshmërisë brenda kësaj shtrirjeje përcaktohet në bazë të tërësisë së rrethanave dhe peshës së shkeljes së sportistit apo personit tjetër për sa i përket shkeljes së dytë.

**10.9.1.2.** Shkelja e tretë e rregullit anti-doping gjithmonë sjell periudhën e përhjetshme të papranueshmërisë, përveç nëse shkelja e tretë plotëson kushtin për eliminimin ose shkurtimin e periudhës së papranueshmërisë sipas nenit 10.5 ose 10.6, ose përbën shkelje të nenit 2.4. Në këto raste të veçanta, periudha e papranueshmërisë mund të jetë nga tetë (8) vjet deri në periudhë të përhjetshme të papranueshmërisë.

**10.9.1.3.** Periudha e papranueshmërisë e përcaktuar në nenet 10.9.1.1 dhe 10.9.1.2 mund të shkurtohet tutje me zbatimin e nenit 10.7.

**10.9.2.** Shkelja e rregullit anti-doping për të cilën sportisti apo personi tjetër ka demonstruar të mos ketë fajësi apo neglizhencë nuk konsiderohet shkelje për qëllimet e këtij neni 10.9. Përveç kësaj, shkelja e rregullave anti-doping e sanksionuar sipas nenit 10.2.4.1 nuk konsiderohet shkelje për qëllimet e nenit 10.9.

**10.9.3.** Rregulla plotësuese për disa shkelje të mundshme të shumëfishta

**10.9.3.1.** Për qëllime të shqiptimit të sanksioneve sipas nenit 10.9, përveç sipas dispozitave të neneve 10.9.3.2 dhe 10.9.3.3, shkelja e rregullit anti-doping konsiderohet shkelje e dytë vetëm nëse KosADA arrin të vërtetojë se sportisti apo personi tjetër ka kryer shkelje plotësuese të rregullit anti-doping pasi që sportisti apo personi tjetër ka marrë njoftimin sipas nenit 7, apo pasi që KosADA të ndërmarrë veprimet e arsyeshme për t'i dorëzuar njoftimin për shkeljen e parë të rregullit anti-doping. Nëse KosADA nuk arrin ta vërtetojë këtë, shkeljet do të merren parasysh së bashku si një shkelje e vetme e parë, ndërsa sanksioni i shqiptuar bazohet në shkeljen që mbart sanksionin më të ashpër, duke përfshirë edhe aplikimin e rrethanave rënduese. Rezultatet në të gjitha garat, duke nisur nga shkelja e mëhershme e rregullit anti-doping diskualifikohen sipas dispozitës së nenit 10.10. 1

**10.9.3.2.** Nëse KosADA konstaton se sportisti apo personi tjetër ka kryer shkelje tjetër të rregullit anti-doping para pranimit të njoftimit, si dhe që shkelja e tillë ka ndodhur dymbëdhjetë (12) muaj apo më shumë para apo pas shkeljes për të cilën është bërë njoftimi, atëherë periudha e papranueshmërisë për shkeljen plotësuese llogaritet sikur shkelja plotësuese e tillë të ishte shkelje e parë e vetme, ndërsa periudha e papranueshmërisë shqiptohet vijimisht, e jo paralelisht, me periudhën e papranueshmërisë të shqiptuar për shkeljen e njoftuar më së pari. Kur zbatohet neni 10.9.3.2, shkeljet, të marra së bashku, përbëjnë një shkelje të vetme për qëllimet e nenit 10.9.1.

**10.9.3.3.** Nëse KosADA konstaton se sportisti apo personi tjetër ka kryer shkelje të nenit 2.5, në lidhje me procesin e kontrollit të dopingut për një shkelje të pretenduar të rregullit

antidoping, shkelja e nenit 2.5 trajtohet si shkelje e parë e vetme, ndërsa periudha e papranueshmërisë për shkeljen e tillë shqiptohet vijimisht, e jo paralelisht, me periudhën e papranueshmërisë, nëse ka, të shqiptuar për shkeljen fillestare të rregullit anti-doping. Kur zbatohet ky nen 10.9.3.3, shkeljet, të marra së bashku, përbëjnë shkelje të vetme për qëllimet e nenit 10.9.1.

**10.9.3.4.** Nëse KosADA vërteton se personi ka kryer shkelje të dytë apo të tretë të rregullave anti-doping gjatë periudhës së papranueshmërisë, periudhat e papranueshmërisë për shkeljet e shumta pësohen njëra pas tjetrës, e jo paralelisht.

**10.9.4.** Shkeljet e shumëfishta të rregullit anti-doping gjatë periudhës dhjetë (10) vjeçare Për qëllime të nenit 10.9, çdo shkelje e rregullit anti-doping duhet të ketë ndodhur brenda së njëjtës periudhë dhjetë (10) vjeçare për t'u konsideruar shkelje e shumëfishtë.

## **10.10. Diskualifikimi i rezultateve në garat pas marrjes së mostrës apo kryerjes së shkeljes së rregullit anti-doping**

Përveç diskualifikimit automatik të rezultateve në garë që ka nxjerrë mostrën positive sipas nenit 9, të gjitha rezultatet e tjera garuese të sportistit të siguar nga data kur është marrë mostra pozitive (qoftë në garë apo jashtë garës), ose ka ndodhur shkelje tjetër e rregullave anti-doping, përgjatë fillimit të cilësdo pezullimit të përkohshëm apo të periudhës së papranueshmërisë, përveç rasteve kur drejtësia kërkon ndryshe, diskualifikohen me të gjitha pasojat që lindin, duke përfshirë edhe revokimin e çfarëdo medaljeje, pikëve dhe çmimeve.

## **10.11. Paratë e konfiskuara të çmimeve**

Nëse KosADA rimerr paratë e çmimeve të konfiskuara si pasojë e shkeljes së rregullave anti-doping, KosADA merr masa të arsyeshme për të ndarë dhe shpërndarë ato para të çmimit(eve) të cilat do të përfitoheshin nga sportistët nëse sportisti të cilit i është konfiskuar çmimi nuk do të kishte garuar.



## **10.12. Pasojat financiare**

**10.12.1.** Kur një sportist apo një person tjetër kryen shkelje të rregullit anti-doping, KosADA, sipas gjykimit të saj dhe në varësi të parimit të proporcionalitetit, mund të zgjedhë që (a) të rimarrë nga sportisti ose personi tjetër shpenzimet që lidhen me shkeljen e rregullit anti-doping, pavarësisht nga periudha e papranueshmërisë që është shqiptuar dhe/ose (b) të gjobisë sportistin ose personin tjetër me shumë deri në 10.000 euro vetëm në rastet kur përndryshe është shqiptuar tashmë periudha maksimale e papranueshmërisë.

**10.12.2.** Shqiptimi i sanksionit financiar apo rimarrja e shpenzimeve nga KosADA nuk konsiderohet si bazë për shkurtimin e periudhës së papranueshmërisë apo sanksioneve të tjera që përndryshe do të vlenin sipas këtyre rregullave Anti-Doping.

## **10.13. Fillimi i Periudhës së Papranueshmërisë**

Kur sportisti është duke vuajtur tashmë periudhën e papërshtatshmërisë për shkeljen e rregullit anti-doping, çfarëdo periudhë e re e papranueshmërisë fillon në ditën e parë pas kalimit të periudhës aktuale të papranueshmërisë. Përndryshe, përveç siç parashikohet më poshtë, periudha e papranueshmërisë fillon në datën e vendimit përfundimtar të seancës dëgjimore që përcakton pranueshmërinë, ose, nëse seanca shtyhet apo nuk mbahet, në datën kur është pranuar njoftimi për papranueshmëri ose ndryshe shqiptohet.

### **10.13.1. Vonesat që nuk shkaktohen nga sportisti apo personi tjetër**

Kur ndodhin vonesa të konsiderueshme në procesin e dëgjimit apo aspekte të tjera të kontrollit të dopingut, ndërsa sportisti apo personi tjetër mund të dëshmojë se vonesat e tilla nuk i atribuohen sportistit apo personit tjetër, KosADA apo kolegji shqyrtues i KosADA-së, sipas rastit, mund të fillojë periudhën e papranueshmërisë në datë më të hershme, me fillim që në datën e marrjes së mostrës apo datën kur ka ndodhur shkelja më e fundit e rregullit anti-doping. Të gjitha rezultatet garuese të arritura gjatë periudhës së papranueshmërisë, duke përfshirë Papranueshmërinë retroaktive, diskualifikohen.

### **10.13.2. Kredia për pezullim të përkohshëm apo periudhë të papranueshmërisë të kryer**

Nëse pezullimi i përkohshëm respektohet nga sportisti apo personi tjetër, atëherë sportisti apo personi tjetër merr kredi për atë periudhë të pezullimit të përkohshëm që vlen ndaj periudhës së papranueshmërisë që mund të shqiptohet përfundimisht. Nëse sportisti apo personi tjetër nuk respekton pezullimin e përkohshëm, atëherë sportisti apo personi tjetër nuk merr kredi për asnjë periudhë të pezullimit të përkohshëm të vuajtur tashmë. Nëse periudha e papranueshmërisë shërbehet sipas një vendimi që apelohe më pas, atëherë sportisti apo personi tjetër merr kredinë për atë periudhë të papranueshmërisë së vuajtur tashmë që vlen për periudhën e mundshme të papranueshmërisë që mund të shqiptohet në apel.

**10.13.2.1.** Nëse sportisti ose personi tjetër pranon vullnetarisht pezullimin e përkohshëm me shkrim nga KosADA dhe më pas respekton pezullimin e përkohshëm, sportisti apo personi tjetër merr kredi për atë periudhë të pezullimit të përkohshëm vullnetar që vlen për barazim me periudhën e papranueshmërisë që mund të shqiptohet në fund. Një kopje e pranimi vullnetar të pezullimit të përkohshëm nga sportisti apo personi tjetër i dorëzohet menjëherë secilës palë që ka interes të marrë njoftimin për shkeljen e pretenduar të rregullit anti-doping sipas nenit 14.1.5.

**10.13.2.2.** Nuk mund të akordohet kredia për periudhë të papranueshmërisë për ndonjë periudhë kohore përpara datës efektive të pezullimit të përkohshëm ose pezullimit të përkohshëm vullnetar, pavarësisht nëse sportisti ka vendosur të mos garojë apo është pezulluar nga ekipi.

**10.13.2.3.** Në sportet ekipore, kur ekipit i shqiptohet masa e periudhës së papranueshmërisë, përveç rasteve kur drejtësia kërkon ndryshe, periudha e papranueshmërisë fillon në datën e vendimit përfundimtar të seancës dëgjimore që përcakton papranueshmërinë, ose nëse nuk mbahet seanca, në datën e pranimi apo ndryshe shqiptimit të masës së papranueshmërisë. Çdo periudhë e pezullimit të përkohshëm të ekipit (qoftë e shqiptuar apo e pranuar vullnetarisht) barazohet si kredi në periudhën e plotë të papranueshmërisë të shqiptuar si masë.

## **10.14. Statusi gjatë papranueshmërisë apo pezullimit të përkohshëm**

### **10.14.1. Ndalimi i pjesëmarrjes gjatë papranueshmërisë apo pezullimit të përkohshëm**

Sportisti apo personi tjetër që është shpallur i papranueshëm apo nën masën e pezullimit të përkohshëm mundet, gjatë periudhës së papranueshmërisë apo pezullimit të përkohshëm, të marrë pjesë në çfarëdo cilësie në garë apo aktivitet (përveç programeve të autorizuara të edukimit apo rehabilitimit anti-doping) të autorizuara apo organizuara nga cilado organizatë anëtare nënshkruese, organizatë anëtare e palës nënshkruese, apo ndonjë klub apo organizatë tjetër anëtare të organizatës anëtare të palës nënshkruese, apo në garat e autorizuara apo organizuara nga cilado ligë profesionale apo në organizime të nivelit shtetëror të organizimeve apo në aktivitete të tjera elitare apo të nivelit shtetëror të sportit që financohet nga një agjenci qeveritare.

Sportisti apo personi tjetër që i nënshtrohet periudhës së papranueshmërisë më të gjatë se katër (4) vjet, pas vuajtjes së katër (4) viteve të periudhës së papranueshmërisë, mund të marrë pjesë si sportist në ngjarje sportive lokale që nuk sanksionohen apo ndryshe vepronë nën ombrellën e një pale Nënshkruese Kodi ose një anëtar të një pale Nënshkruese të Kodit, por vetëm për atë sa ngjarja sportive lokale nuk është në nivel që përndryshe mund ta kualifikojë atë sportiest apo person tjetër drejtpërdrejt ose tërthorazi për të garuar në (ose për të grumbulluar pikë drejt saj) kampionat kombëtar apo ngjarje ndërkombëtare, si dhe nuk angazhon sportistin apo personin tjetër që punon në çfarëdo cilësie me Personat e Mbrojtur.

Sportisti apo personi tjetër të cilit i është shqiptuar periudha e papranueshmërisë mbetet i detyruar t'i nënshtrohet testimit dhe secilit kriter të KosADA-s për të ofruar informatat për vendndodhjen e tij/saj.

### **10.14.2. Kthimi në stërvitje**

Si përjashtim nga neni 10.14.1, sportisti mund të kthehet në stërvitje me ekip apo të shfrytëzojë hapësirat e mjetet e një klubi apo organizate tjetër anëtare të KosADA-s apo ndonjë organizate tjetër anëtare nënshkruese në periudhën që është më e shkurtra nga këto: (1) dy muajt e fundit të periudhës së papranueshmërisë së sportistit, apo (2) çereku i fundit i periudhës së shqiptuar të papranueshmërisë.

### **10.14.3.** Shkelja e ndalimit të pjesëmarrjes gjatë papranueshmërisë ose pezullimit të përkohshëm

Kur sportisti apo personi tjetër i shpallur i papranueshëm shkel ndalimin e pjesëmarrjes gjatë papranueshmërisë të përshkruar në nenin 10.14.1, rezultatet e pjesëmarrjes së tillë diskualifikohen, si dhe periudhës fillestare të papranueshmërisë i shtohet një periudhë e re e papranueshmërisë në kohëzgjatje të barabartë me periudhën fillestare. Periudha e re e papranueshmërisë, duke përfshirë qortimin dhe pa shtimin e periudhës së papranueshmërisë, mund të përshtatet ndaj shkallës së fajësisë së sportistit apo personit tjetër, si dhe rrethanave të tjera të rastit. Përcaktimi nëse sportisti apo personi tjetër ka shkelur ndalimin e pjesëmarrjes, si dhe nëse nevojitet përshtatja e masës, bëhet nga organizata Anti-Doping, menaxhimi i rezultateve të së cilës ka shpënë në shqiptimin e periudhës fillestare të papranueshmërisë. Ky vendim mund të ankimohet sipas nenit 13.

Sportisti apo personi tjetër që shkel ndalimin e pjesëmarrjes gjatë pezullimit të përkohshëm të përshkruar në Nenin 10.14.1 nuk përfiton kredi për asnjë periudhë të pezullimit të përkohshëm të vuajtur tashmë dhe rezultatet e pjesëmarrjes së tillë diskualifikohen.

Kur Personi Mbështetës i Sportistit apo personi tjetër ndihmon personin në shkeljen e ndalimit të pjesëmarrjes gjatë periudhës së papranueshmërisë apo pezullimit të përkohshëm, KosADA shqipton sanksione për shkeljen e Nenit 2.9 për ndihmën e tillë.

### **10.14.4.** Tërheqja e mbështetjes financiare gjatë papranueshmërisë

Përveç këtyre, për secilën shkelje të rregullit anti-doping që nuk rezulton me sanksion të reduktuar sipas nenit 10.5 ose 10.6, disa ose e gjithë mbështetja financiare ndërlidhur me sported apo të tjera beneficione sportive të përfituara nga ai person do të mbahen nga KosADA, Qeveria e Kosovës, Komiteti Olimpik Kombëtar i Kosovës, Komiteti Paralimpik Kombëtar i Kosovës dhe Federatat Kombëtare.

Gjatë periudhës së trajnimit të përshkruar në këtë nen, sportisti i papranueshëm nuk mund të garojë, e as të angazhohet në asnjërin aktivitet të përshkruar në nenin 10.14.1, përveç trajnimit.

## **10.15. Publikimi automatik i sanksionit**

Një pjesë e detyrueshme e secilit sanksion përfshin publikimin automatik, siç parashihet me nenin 14.3.

## **Neni 11 Pasojat për ekipe**

### **11.1. Testimi i sporteve ekipore**

Kur më shumë se një (1) anëtar ekipi në një sport ekipor është njoftuar për shkelje të rregullit anti-doping sipas nenit 7 në lidhje me një ngjarje, organi vendim-marrës për ngjarjen duhet të bëjë testimin e shënjestruar të ekipit gjatë Periudhës së Ngjarjes.

### **11.2. Pasojat për Sportet Ekipore**

Nëse më shumë se dy (2) anëtarë ekipi në një sport ekipor zbulohen të kenë kryer shkelje të rregullit anti-doping gjatë periudhës së ngjarjes, organi vendim-marrës i ngjarjes shqipton sanksionin përkatës ndaj ekipit (p.sh. Humbje pikësh, Diskualifikim nga gara apo ngjarja, apo sanksion tjetër), përtej pasojave të mundshme të shqiptuara ndaj sportistëve individualë që kryejnë shkeljen e rregullave anti-doping.

### **11.3. Organi vendim-marrës i ngjarjes mund të vendosë pasoja më të rrepta për sported ekipore**

Organi vendim-marrës për ngjarjen mund të zgjedhë të vendosë rregulla për ngjarjen, të cilat shkaktojnë pasoja për sportet ekipore që janë më të rrepta se ato në nenin 11.2, për qëllime të vetë ngjarjes.

## **NENI 12 Sanksionet nga KosADA ndaj organeve të tjera sportive**

Kur KosADA merr njohuri që një Federatë Kombëtare në Kosovë, apo ndonjë organ tjetër sportiv në Kosovë, e mbi të cilin ka autoritet, ka dështuar t'i bindet, nuk ka zbatuar, respektuar apo përmbaaruar këto rregulla Anti-Doping në kuadër të fushave të përgjegjësisë së asaj organizate apo organi, KosADA mund të zgjedhë t'i kërkojë Komitetit Olimpik të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, apo Federatave ndërkombëtare që

të ndërmarrin veprimet plotësuese disiplinore si në vijim, ose, aty ku ka mandat, të ndërmarrë vetë veprimet plotësuese disiplinore si vijon:

**12.1.** Të përjashtojë të gjithë, apo ndonjë grup, anëtarë të asaj organizate apo organi nga ngjarjet e ardhshme të specifikuara ose të gjitha ngjarjet e mbajtura gjatë një periudhe të caktuar kohore.

**12.2.** Të marrë masa plotësuese disiplinore për sa i përket njohjes së asaj organizate apo organi, pranueshmërisë së anëtarëve të tyre për pjesëmarrje në aktivitetet e KosADA-s, si dhe/ose të gjobisë atë organizatë apo organ, me bazat si në vijim:

**12.2.1.** Katër (4) apo më shumë shkelje të këtyre rregullave Anti-Doping (përveç shkeljeve lidhur me Nenin 2.4) kryhen nga sportistët apo personat e tjerë të ndërlidhur me atë organizatë apo organ gjatë një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore. Në rastet e tilla: (a) të gjithëve apo një grupi anëtarësh të asaj organizate apo organi mund t'iu ndalohet pjesëmarrja në çfarëdo aktiviteti në Kosovë për një periudhë deri në dy (2) vjet dhe/ose (b) ajo organizatë apo organ mund të gjobitet me shumë deri në 10.000 [Euro].

**12.2.2.** Katër (4) apo më shumë shkelje të këtyre rregullave Anti-Doping (përveç shkeljeve lidhur me nenin 2.4) kryhen përtej shkeljeve të përshkruara në nenin 12.2.1. nga sportistët apo persona të tjerë të ndërlidhur me atë organizatë apo organ gjatë një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore. Në rastin e tillë, ajo organizatë apo organ mund të pezullohet për një periudhë deri në katër (4) vjet.

**12.2.3.** Më se një sportist apo person tjetër i ndërlidhur me atë organizatë apo organ kryen shkelje të rregullave anti-doping gjatë një ngjarjeje ndërkombëtare. Në këtë rast, ajo organizatë apo organ mund të gjobitet në shumë deri në 10.000 [Euro]

**12.2.4.** Ajo organizatë apo organ ka dështuar të bëjë përpjekjet e arsyeshme për ta informuar KosADA-n për vendndodhjen e sportistit pas marrjes së kërkesës për ato informata nga KosADA. Në këtë rast, organizata apo organi mund të gjobitet në shumë deri në 10.000 [Euro] për sportist, si shtesë ndaj rimbursimit të të gjitha shpenzimeve të KosADA-s të pësura gjatë testimit të sportistëve të asaj organizate apo organi.

**12.3.** Të ndalojë pjesë apo tërësisht fondet apo mbështetje tjetër financiare dhe jofinanciare për atë organizatë ose organ.

**12.4.** Të obligojë atë organizatë apo organ të kompensojë KosADA-n për të gjitha shpenzimet (duke përfshirë, pa u kufizuar në to, faturat e laboratorëve, shpenzimet e seancave, si dhe të udhëtimit) që lidhen me shkeljen e këtyre rregullave Anti-Doping të kryer nga sportisti apo personi tjetër i lidhur me atë organizatë ose organ.

## **NENI 13 Menaxhimi i rezultateve apeli**

### **13.1. Vendimet që i nënshtrohen apelit**

Vendimet e marra sipas kodit ose këtyre rregullave Anti-Doping mund të apelojnë sipas dispozitave të mëposhtme në nenet 13.2 deri në 13.7 ose siç parashikohet ndryshe në këto rregulla Anti-Doping, në Kod, apo Standarde Ndërkombëtare. Vendimet e tilla mbeten në fuqi gjatë procedurës së apelit, përveç nëse organi i apelit urdhëron ndryshe.

#### **13.1.1. Fushëveprimi i shqyrtimit nuk kufizohet**

Fushëveprimi i shqyrtimit në apel përfshin të gjitha çështjet që lidhen me rastin, si dhe shprehimisht nuk kufizohet në rast apo fushëveprimin e shqyrtimit përpara vendimmarrësit fillestar. Secila palë në apel mund të parashtrojë prova, argumente ligjore dhe pretendime që nuk janë ngritur në seancën e shkallës së parë, për aq sa rrjedhin nga i njëjti shkak i veprimit ose të njëjtat fakte apo rrethana të përgjithshme të ngritura apo trajtuara në seancën e shkallës së parë.

**13.1.2.** CAS në marrjen e vendimit të vet, CAS nuk i jep përparësi diskrecionit të ushtruar nga organi, vendimi i të cilit është apeluar.

#### **13.1.3. WADA nuk obligohet të shterojë mjetet e brendshme**

Kur WADA ka të drejtë apeli sipas nenit 13 si dhe asnjë palë tjetër nuk apelon vendimin përfundimtar në kuadër të procesit të KosADA-s, WADA mund ta apelojë atë vendim drejtpërdrejt në KAS pa pasur nevojë të shterojë mjetet tjera juridike në procesin e KosADA-s.

### **13.2. Ankesat ndaj vendimeve në lidhje me shkeljet e rregullave anti-doping, pasojat, pezullimet e përkohshme, zbatimi i vendimeve dhe autorizimi**

Vendimi që është kryer shkelja anti-doping, vendimi që shqipton pasoja apo që nuk vendos pasoja për shkelje të rregullit anti-doping, apo një vendim që nuk është kryer shkelja e rregullit anti-doping; vendimi që procedura e shkeljes së rregullit anti-doping nuk mund të vazhdojë për shkaqe procedurale (duke përfshirë, për shembull, për shkak të parashkrimit); vendimi nga WADA për të mos lejuar përjashtim nga obligimi i njoftimit gjashtë (6) mujor për sportistin e pensionuar për t'u kthyer në gara sipas nenit 5.6.1; vendimi nga WADA që cakton menaxhimin e rezultateve sipas nenit 7.1 të Kodit; vendimi nga KosADA për të mos parashtruar konstatime analitike negative apo konstatime jotipike si shkelje të rregullave anti-doping, apo vendimi për të mos ngarkuar shkelje të rregullave anti-doping pas hetimit në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhim të Rezultateve, vendimi për të shqiptuar, apo pushuar, pezullimin e përkohshëm si rezultat i seancës së përkohshme; dështimi nga KosADA në respektim të nenit 7.4; vendimi që KosADA shpallet jokompetente për të vendosur shkeljen e pretenduar të rregullave anti-doping apo Pasojat e saj; vendimi për të pezulluar, apo për të mos pezulluar, pasojat apo për të rivendosur, apo për të mos rivendosur, pasojat sipas nenit 10.7.1; dështimi për të respektuar nenet 7.1.4 dhe 7.1.5 të Kodit; dështimi për të respektuar nenin 10.8.1; vendimi sipas nenit 10.14.3; vendimi nga KosADA për të mos zbatuar vendimin e një organizate tjetër Anti-Doping sipas nenit 15; si dhe vendimi sipas nenit 27.3 të Kodit mund të apelohej ekskluzivisht sipas dispozitës së këtij neni 13.2.

**13.2.1.** Apelet që kanë për palë sportistë të nivelit ndërkombëtar apo ngjarje ndërkombëtare

Në rastet që lindin nga pjesëmarrja në ngjarje ndërkombëtare apo në rastet që kanë për palë sportistët e nivelit ndërkombëtar, vendimi mund të apelohej ekskluzivisht në KAS.

**13.2.2.** Apelet që për palë kanë sportistë të tjerë apo persona të tjerë

Në rastet kur nuk zbatohet neni 13.2.1, vendimi mund të apelohej ekskluzivisht në KAS në përputhje me rregulloren e punës në fuqi.



### **13.2.3. Personat me të drejtë apelimi**

**13.2.3.1.** Apelet që kanë për palë sportistë të nivelit ndërkombëtar apo ngjarje ndërkombëtare

Në rastet sipas nenit 13.2.1, palët vijuese kanë të drejtën e apelimit në KAS. (a) sportisti apo personi tjetër që është subjekt i vendimit që apelohe; (b) pala kundërshtarë në rastin për të cilën është marrë vendimi; (c) Federata përkatëse ndërkombëtare; (d) KosADA dhe (nëse ka tjetër) Organizata Kombëtare Anti-Doping e shtetit të qëndrimit të personit ose vendeve ku personi është shtetas ose bartës i licencës; (e) Komiteti Olimpik Ndërkombëtar apo Komiteti Ndërkombëtar Paralimpik, sipas rastit, kur vendimi mund të ketë ndikim në lidhje me Lojërat Olimpike ose Lojërat Paralimpike, duke përfshirë vendimet që ndikojnë në normat e pranimit për Lojërat Olimpike ose Lojërat Paralimpike; si dhe (I) WADA.

**13.2.3.2.** Apelet që për palë kanë sportistë të tjerë apo persona të tjerë

Në rastet sipas nenit 13.2.2, palët vijuese kanë të drejtën e apelimit: (a) sportisti apo personi tjetër është subjekt i vendimit që apelohe; (b) pala kundërshtarë në rastin për të cilin është marrë vendimi; (c) Federata përkatëse ndërkombëtare; (d) KosADA dhe (nëse ka tjetër) Organizata Kombëtare Anti-Doping e shtetit të qëndrimit të personit ose vendeve ku personi është shtetas ose bartës i licencës; (e) Komiteti Olimpik Ndërkombëtar apo Komiteti Ndërkombëtar Paralimpik, sipas rastit, kur vendimi mund të ketë ndikim në lidhje me Lojërat Olimpike ose Lojërat Paralimpike, duke përfshirë vendimet që ndikojnë në normat e pranimit për Lojërat Olimpike ose Lojërat Paralimpike; si dhe (I) WADA.

Secila palë që parashtron apel ka të drejtë për ndihmë nga KAS, për të marrë gjitha informatat përkatëse nga Organizata Anti-Doping, vendimi i së cilës apelohe, si dhe informatat duhen siguruar nëse KAS urdhëron atë.

**13.2.3.3.** Detyrimi për njoftim

Të gjitha palët në secilin apel para KAS duhet të sigurojë që WADA dhe të gjitha palët tjera me të drejtë apeli të njoftohen me kohë për apelin.

#### **13.2.3.4. Apeli ndaj shqiptimit të pezullimit të përkohshëm**

Pa anashkaluar dispozitat e këtushme, i vetmi person që mund të apelojë ndaj shqiptimit të pezullimit të përkohshëm është sportisti apo personi tjetër ndaj të cilit është shqiptuar pezullimi i përkohshëm.

#### **13.2.3.5. Apeli ndaj vendimeve sipas nenit 12**

Vendimet e KosADA-s sipas nenit 12 mund të apeloohen ekskluzivisht në KAS nga Federata Kombëtare apo një organ tjetër.

#### **13.2.4. Kundër-apeli dhe apelet tjera vijuese lejohen**

Kundër-apelet dhe apelet tjera vijuese nga cilado palë e paditur e përmendur në rastet e ngritura në KAS sipas kodit lejohen në mënyrë specifike. Secila palë me të drejtë apeli sipas nenit 13 duhet të paraqesë kundër-apel apo apel të mëvonshëm më së voni pas parashtrimit të përgjigjes së palës.

### **13.3. Dështimi nga KosADA për nxjerrjen e vendimit me kohë**

Në rastet e veçanta kur KosADA nuk merr vendim lidhur me atë nëse është kryer shkelja e rregullit anti-doping brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga WADA, WADA mund të zgjedhë të parashtrijë apelin drejtpërdrejt në KAS sikur KosADA të kishte vendosur që nuk ka pasur shkelje të rregullave anti-doping. Nëse kolegji shqyrtues i KAS vendos se ka shkelje të rregullave anti-doping dhe se WADA ka vepruar në mënyrë të arsyeshme që ka vendosur të apelojë drejtpërdrejt në KAS, atëherë shpenzimet e WADA-s dhe shpenzimet e avokatit për parashtrimin e apelit duhen kompensuar tek WADA nga KosADA.

### **13.4. Apelet lidhur me TUE**

Vendimet për TUE mund të apeloohen ekskluzivisht sipas dispozitës së 4.4.

### **13.5. Njoftimi për vendimet për apel**

KosADA duhet që menjëherë t'i dorëzojë vendimin e apelit sportistit apo personit tjetër dhe organizatave të tjera Anti-Doping që do të kishin të drejtë të apelonin sipas Nenit 13.2.3, sipas dispozitave të nenit 14.2.

## **13.6. Afati për paraqitjen e apeleve**

### **13.6.1. Apeli në KAS**

Afati për parashtrimin e apelit në KAS është njëzet e një (21) ditë nga data e pranimit të vendimit nga pala apeluese. Pa anashkaluar dispozitën e sipërme, pikat vijuese zbatohen lidhur me apelet që parashtrihen nga palët që kanë të drejtë apeli, por që nuk kanë qenë pjesë e procedurës që ka çuar tek vendimi që apelohej:

**(a)** Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit, pala/ët e tilla kanë të drejtë të kërkojnë kopje të shkresave të rastit lidhur me vendimin nga Organizata Anti-Doping që ka pasur autorizimin për menaxhim të rezultateve;

**(b)** Nëse kërkesa e tillë bëhet brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditësh, atëherë pala kërkuese ka njëzet e një (21) ditë nga pranimi i shkresave të rastit që të parashtrojë apelin në KAS.

Pa anashkaluar pikat si më sipër, afati i parashtrimit për apel të dorëzuar nga WADA është më i vonshmi nga këto afate:

**(a)** Njëzet e një (21) ditë pas ditës së fundit në të cilën pala tjetër që ka të drejtë ankese ka mundur të apelojë, ose

**(b)** Njëzet e një (21) ditë pas pranimit nga WADA të shkresave të rastit në lidhje me vendimin.

## **NENI 14 Konfidencialiteti dhe raportimi**

### **14.1. Informatat lidhur me konstatimet analitike negative, konstatimeve jotipike, si dhe shkeljet tjera të pohuara të rregullave anti-doping**

**14.1.1.** Njoftimi për shkeljet e Rregullave Anti-Doping për sportistët dhe personat e tjerë  
Njoftimi për sportistët apo personat e tjerë për shkelje të rregullave anti-doping të cilat i ngarkohen duhet të bëhet sipas dispozitave të neneve 7 dhe 14. Nëse në cilindo moment gjatë menaxhimit të rezultateve deri në akuzën e shkeljes së rregullave anti-doping, KosADA vendos të mos vazhdojë me atë rast, ajo duhet të njoftojë sportistin apo personin

tjetër (me kusht që sportisti apo personi tjetër të jenë të informuar tashmë për menaxhimin e rezultateve në zhvillim).

#### **14.1.2. Njoftimi për shkeljet e Rregullave Anti-Doping për Organizatat Kombëtare Anti-Doping, Federatat Ndërkombëtare dhe WADA**

Njoftimi për pohimin e shkeljes së rregullit anti-doping për Organizatën Kombëtare Anti-Doping të Sportistit apo personit tjetër, nëse nuk është KosADA, Federata Ndërkombëtare dhe WADA, bëhet sipas dispozitave të neneve 7 dhe 14, njëkohësisht me njoftimin për sportistin apo personin tjetër. Nëse në cilindo moment gjatë menaxhimit të rezultateve deri në akuzën e shkeljes së rregullave anti-doping, KosADA vendos të mos vazhdojë me atë rast, ajo duhet të njoftojë (me arsyetim) Organizatat Anti-Doping që kanë të drejtë apeli sipas nenit 13.2.3.

#### **14.1.3. Përmbajtja e njoftimit për Shkeljen e Rregullave Anti-Doping**

Njoftimi i shkeljes së rregullit anti-doping përmban: emrin e sportistit apo personit tjetër, shtetin, sportin dhe disiplinën brenda sportit, nivelin garues të sportistit, nëse testi është bërë gjatë apo jashtë garës, datën e marrjes së mostrës, rezultatin analitik të raportuar nga laboratorit dhe informata të tjera siç kërkohen me Standardin Ndërkombëtar për testim dhe hetime, si dhe standardin Ndërkombëtar për Menaxhim të Rezultateve. Njoftimi për shkelje të rregullave anti-doping ndryshe nga neni 2.1, përmban edhe rregullin e shkelur dhe bazën e shkeljes së pohuar.

#### **14.1.4. Raportet e gjendjes**

Përveç në lidhje me hetimet që nuk kanë rezultuar me njoftim për shkelje të rregullave antidoping në përputhje me nenin 14.1.1, Organizata Kombëtare Anti-Doping e Sportistit apo personit tjetër, nëse nuk është KosADA, Federata Ndërkombëtare dhe WADA, duhet të njoftohet rregullisht mbi statusin dhe konstatimet e cilitdo shqyrtim apo procedurë e mbajtur sipas neneve 7, 8 apo 13, si dhe t'i jepet menjëherë shpjegimi i arsyetuar me shkrim, apo vendimi që shpjegon zgjidhjen e rastit.

#### **14.1.5. Konfidencialiteti**

Organizatat pranuese nuk do ta shpalosin këtë informacion përtej personave që kanë nevojë të dinë (gjë që përfshin personelin përkatës në Komitetin Olimpik Kombëtar,

Federatën Kombëtare dhe ekipin në sport ekipore, përkatësisht) derisa KosADA të ketë bërë shpalosjen publike siç parashihet me nenin 14.3.

**14.1.6.** Mbrojtja e konfidencialitetit të informatave nga punëtorët apo zyrtarët e KosADA. KosADA duhet të sigurojë që informatat lidhur me konstatimet analitike negative, konstatimet jotipike, si dhe shkeljet e tjera të pohuara të rregullave anti-doping të mbeten konfidenciale derisa informatat e tilla të shpalosen publikisht në pajtim me nenin 14.3. KosADA duhet të sigurojë që punonjësit e saj (qoftë të përhershëm apo të tjerë), kontraktorët, agjentët, konsulentët dhe palët e treta të deleguara të ngarkohen me kontratë me detyrimin tërësisht të përmbartueshëm të konfidencialitetit, si dhe me procedurë tërësisht të përmbartueshme për hetimin dhe disiplinimin e shpalosjes së pahijshme dhe/ose të paautorizuar të informatave të tilla konfidenciale.

## **14.2. Njoftimi për shkeljen e rregullave Anti-Doping ose shkeljet e periudhës së papranueshmërisë apo vendimeve për pezullim të përkohshëm, si dhe kërkesa për shkresa rasti**

**14.2.1.** Vendimet lidhur me shkeljen e rregullave anti-doping apo vendimet lidhur me shkeljet e periudhës së papranueshmërisë apo pezullimit të përkohshëm të marrë në pajtim me nenet 7.6, 8.2, 10.5, 10.6, 10.7, 10.14.3 ose 13.5 duhet të përmbajnë arsyetimin e plotë për vendimin, duke përfshirë, sipas rastit, arsyetimin se pse nuk është shqiptuar sanksioni më i rreptë i mundshëm. Kur vendimi nuk gjendet në anglisht apo frëngjisht, KosADA duhet të sigurojë një përmbledhje në anglisht ose frëngjisht të vendimit, si dhe arsyetimin përkatës.

**14.2.2.** Organizata Anti-Doping që ka të drejtë të apelojë vendimin e pranuar sipas nenit 14.2.1, mundet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i tij, të kërkojë kopje të shkresave të plota të rastit lidhur me atë vendim.

## **14.3. Shpalosja publike**

**14.3.1.** Pasi që njoftimi t'i dorëzohet sportistit apo personit tjetër në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve, si dhe organizatave përkatëse Anti-Doping në pajtim me nenin 14.1.2, identiteti i sportistit apo personit tjetër që njoftohet për shkeljen potenciale të rregullit anti-doping, substanca e ndaluar ose metoda e ndaluar si dhe

natyra e shkeljes në fjalë, si dhe nëse sportisti apo personi tjetër i nënshtrohet pezullimit të përkohshëm, mund të shpaloset publikisht nga KosADA.

**14.3.2.** Jo më vonë se njëzet (20) ditë pasi të jetë përcaktuar në vendimin e apelit sipas nenit 13.2.1 apo 13.2.2, apo që apeli i tillë të jetë hedhur, apo seanca në pajtim me nenin 8 është shmangur, apo pretendimi për shkelje të rregullit anti-doping nuk është kundërshtuar ndryshe brenda afatit, apo çështja është zgjidhur sipas nenit 10.8, apo një periudhë e re e papranueshmërisë, apo qortimi, është shqiptuar sipas nenit 10.14.3, KosADA duhet që publikisht të shpalosë rezultatit e rastit anti-doping, duke përfshirë sportin, rregullin anti-doping të shkelur, emrin e sportistit apo personit tjetër që ka kryer shkeljen, substancën e ndaluar apo metodën e ndaluar në fjalë (nëse ka) si dhe pasojat e shqiptuara. KosADA po ashtu duhet të shpalosë publikisht brenda njëzet (20) ditësh rezultatet e vendimeve të apelit në lidhje me shkeljet e rregullave anti-doping, duke përfshirë informacionin e përshkruar më sipër.

**14.3.3.** Pasi që shkelja e rregullit anti-doping të përcaktohet se është kryer në vendimin e apelit sipas nenit 13.2.1 apo 13.2.2, apo apeli i tillë është hedhur, apo në seancë në pajtim me nenin 8, apo kur seanca e tillë është shmangur, apo pohimi për shkelje të rregullit anti-doping nuk është kundërshtuar ndryshe brenda afatit, apo çështja është zgjidhur sipas nenit 10.8, KosADA mund ta bëjë publik atë përcaktim apo vendim, si dhe mund të komentojë publikisht për këtë çështje.

**14.3.4.** Në secilin rast kur konstatohet, pas seancës shqyrtuese apo të apelit, se sportisti apo personi tjetër nuk ka kryer shkelje të rregullave anti-doping, fakti që vendimi është apeluar mund të shpaloset publikisht. Megjithatë, vetë vendimi dhe faktet bazë nuk mund të shpalosen publikisht, përveçse me pëlqimin e sportistit apo personit tjetër që është subjekt i vendimit. KosADA duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të marrë pëlqimin e tillë, dhe nëse merret pëlqimi, ta shpalosë publikisht vendimin në tërësinë e tij ose në formën e redaktuar që sportisti apo personi tjetër mund ta miratojë.

**14.3.5.** Publikimi do të realizohet më së paku duke vendosur informatat e duhura në faqen e internetit të KosADA-s si dhe duke i lënë informatat për më gjatë se një (1) muaj ose për kohëzgjatjen e periudhës së mundshme të papranueshmërisë.

**14.3.6.** Përveç siç parashihet me nenet 14.3.1 dhe 14.3.3, Organizatat Anti- Doping, Federatat Kombëtare apo laboratorët e akredituar nga WADA, apo zyrtarët e organeve të tilla, nuk mund të komentojnë publikisht mbi faktet specifike të cilitdo rasti në punë (ndryshe nga përshkrimi i përgjithshëm i procesit dhe shkencës) përveç në përgjigje ndaj komenteve publike që i atribuohen apo bazohen në informatat e dhëna nga sportisti, personi tjetër apo përcjellësit e tyre apo përfaqësues të tjerë.

**14.3.7.** Shpalosja e detyrueshme publike që kërkohet në Nenin 14.3.2 nuk është e detyrueshme kur sportisti apo personi tjetër që është konstatuar të ketë kryer shkelje të rregullave antidoping është i mitur, person i mbrojtur apo sportist rekreativ. Çdo shpalosje publike fakultative në rastet që përfshijnë të mitur, persona të mbrojtur apo sportistë rekreativë duhet të bëhet në përshtatshmëri me faktet dhe rrethanat e rastit.

#### **14.4. Raportimi statistikor**

Të paktën çdo vit, KosADA boton publikisht raport të përgjithshëm statistikor të aktiviteteve të saj të kontrollit të dopingut, ku një kopje i ofrohet WADA-s. KosADA gjithashtu mund të publikojë raporte që tregojnë emrin e secilit sportist të testuar dhe datën e çdo testimi.

#### **14.5. Databaza e të dhënave të kontrollit të dopingut dhe monitorimi i pajtueshmërisë**

Për t'i mundësuar WADA-s të kryejë rolin e saj të monitorimit të pajtueshmërisë dhe të sigurojë përdorimin efektiv të resurseve dhe ndarjen e informacionit të vlefshëm të kontrollit të dopingut midis Organizatave Anti-Doping, KosADA i raporton WADA-s informatat lidhur me Kontrollin e Dopingut përmes sistemit ADAMS, duke përfshirë, në veçanti:

**(a)** Të dhënat e pasaportës biologjike të sportistit për sportistët e nivelit ndërkombëtar dhe sportistët e nivelit kombëtar,

**(b)** Informatat e vendndodhjes për sportistët, duke përfshirë ata në grupimet e regjistruara të testimit,

**(c)** Vendimet për TUE, dhe

**(d)** Vendimet për Menaxhimin e Rezultateve, siç kërkohet sipas standardit(eve) ndërkombëtare të zbatueshme.

**14.5.1.** Për të lehtësuar planifikimin e koordinuar të shpërndarjes së testeve, për të shmangur dyfishimin e panevojshëm në testim nga organizata të ndryshme Anti-Doping dhe për të siguruar që profilet e pasaportës biologjike të sportistit të përditësohen, KosADA duhet t'i raportojë të gjitha testet gjatë dhe jashtë garave tek WADA duke futur formularët e kontrollit të dopingut në sistemin ADAMS, në pajtim me kriteret dhe afatet kohore të përfshira në Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet.

**14.5.2.** Për të lehtësuar të drejtat e WADA-s për mbikëqyrje dhe apelim për TUE-të, KosADA duhet të raportojë të gjitha aplikimet, vendimet dhe dokumentacionin përcjellës për TUE me anë të sistemit ADAMS, në përputhje me kriteret dhe afatet kohore të përfshira në Standardin Ndërkombëtar për përjashtimet për përdorim terapeutik.

**14.5.3.** Për të lehtësuar të drejtat e mbikëqyrjes dhe apelistit të WADA-s për Menaxhimin e Rezultateve, KosADA duhet të raportojë informatat vijuese në ADAMS në pajtim me kriteret dhe afatet kohore të përshkruara në Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve: **(a)** njoftimet për shkeljet e rregullave anti-doping dhe vendimet përkatëse për konstatimet analitike negative; **(b)** njoftimet dhe vendimet përkatëse për shkelje të tjera të rregullave anti-doping që nuk janë konstatime analitike negative; **(c)** dështimet në gjetjen e vendndodhjes; dhe **(d)** çdo vendim për shqiptimin, heqjen apo rivendosjen e pezullimit të përkohshëm.

**14.5.4.** Informatat e përshkruara në këtë nen vihen në dispozicion, kudo që është e duhur dhe në përputhje me rregullat në fuqi, të sportistit, Organizatës Kombëtare Anti-Doping të sportistit dhe Federatës Ndërkombëtare, dhe secilës organizatë tjetër Anti-Doping me autoritet testimi ndaj sportistit.



## **14.6. Privatësia e të dhënave**

**14.6.1.** KosADA mund të grumbullojë, ruajë, përpunojë apo shpalojë informata personale lidhur me sportistët dhe personat tjerë kur është e domosdoshme dhe e përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të saj Anti-Doping sipas Kodit, Standardeve Ndërkombëtare (duke përfshirë posaçërisht standardin ndërkombëtar për mbrojtjen e privatësisë dhe informatave personale), këto Rregulla Anti-Doping dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

**14.6.2.** Pa kufizuar pikat sa më sipër, KosADA:

**(a)** Përpunon vetëm informatat personale në pajtim me bazën ligjore të vlefshme;

**(b)** Njofton secilin pjesëmarrës ose person që i nënshtrohet këtyre Rregullave Anti-Doping, në mënyrë dhe formë që është në përputhje me ligjet në fuqi dhe Standardin Ndërkombëtar për mbrojtjen e privatësisë dhe informatave personale, se informatat tyre personale mund të përpunohen nga KosADA dhe personat tjerë për qëllimin e zbatimit të këtyre Rregullave Anti-Doping;

**(c)** Siguron që secili person/agent i palës së tretë (përfshirë çdo palë të tretë të deleguar) me të cilin KosADA ndan informatat personale të cilitdo pjesëmarrësi ose personi, i nënshtrohet kontrolleve përkatëse teknike dhe kontraktuale për të mbrojtur konfidencialitetin dhe privatësinë e atyre informatave.

## **NENI 15 Zbatimi i vendimeve**

### **15.1. Efekti detyrues automatik i vendimeve nga organizatat nënshkruese Anti-Doping**

**15.1.1.** Vendimi për shkeljen e rregullit antidoping marrë nga një organizatë nënshkruese e Antidopingut, organi i apelit (neni 13.2.2 i kodit) ose KAS, pasi të njoftohen palët në procedurë, bëhet automatikisht i detyrueshëm edhe për palët tjera përtej atyre në procedurë pasi që KosADA-s, si dhe secilës Federatë Kombëtare në Kosovë, si dhe çdo palë Nënshkruese në secilin sport, me efektet e përshkruara më poshtë:

**15.1.1.1.** Vendimi nga cilido prej organeve të përshkruara më sipër që shqipton pezullim të përkohshëm (pasi të jetë mbajtur seanca e përkohshme apo sportisti apo personi tjetër

ose ka pranuar pezullimin e përkohshëm ose ka hequr dorë nga e drejta për seancë të përkohshme, seancë apo apel të përshpejtuar të ofruar në përputhje me nenin 7.4.3) (\ automatikisht e ndalon sportistin apo personin tjetër nga pjesëmarrja (siç përshkruhet në nenin 10.14.1) në të gjitha sportet brenda autoritetit të secilës palë nënshkruese gjatë pezullimit të përkohshëm.

**15.1.1.2.** Vendimi nga cilido prej organeve të përshkruara më sipër që shqipton periudhë të papranueshmërisë (pasi është mbajtur seanca apo është shmangur) automatikisht e ndalon sportistin apo personin tjetër nga pjesëmarrja (siç përshkruhet në nenin 10.14.1) në të gjitha sportet brenda autoritetit të secilës palë nënshkruese për periudhën e papranueshmërisë.

**15.1.1.3.** Vendimi i cilitdo prej organeve të përshkruara më sipër që pranon shkeljen e rregullave anti-doping i obligon automatikisht të gjithë nënshkruesit.

**15.1.1.4.** Vendimi nga cilido prej organeve të përshkruara më sipër për të diskualifikuar rezultatet sipas Nenit 10.10 për një periudhë të caktuar diskualifikon automatikisht të gjitha rezultatet e marra brenda autoritetit të secilës palë nënshkruese gjatë periudhës së specifikuar.

**15.1.2.** KosADA dhe secila Federatë Kombëtare në Kosovë duhet të njohë dhe zbatojë vendimin dhe efektet e tij sipas dispozitave të nenit 15.1.1, pa pasur nevojë për veprime të tjera, në datën më të hershme midis datës kur KosADA merr njoftimin aktual të vendimit dhe dates kur vendimi futet në ADAMS.

**15.1.3.** Vendimi i një Organizate Anti-Doping, organi apeli apo KAS për të pezulluar, ose tërhequr, pasojat është detyrues për KosADA-n dhe secilën Federatë Kombëtare në Kosovë, pa pasur nevojë për veprime të tjera, në datën më të hershme midis datës kur KosADA merr njoftimin aktual për vendimin dhe datës kur vendimi është futur në ADAMS.

**15.1.4.** Pa anashkaluar dispozitat e nenit 15.1.1, megjithatë, vendimi për shkeljen e rregullit anti-doping nga një organizatë e ngjarjeve të mëdha, i marrë në proces të përshpejtuar gjatë një ngjarjeje nuk është i detyrueshëm për KosADA-n apo Federatat Kombëtare në Kosovë, përveç nëse rregullat e organizatës së ngjarjeve të mëdha i japin sportistit ose personit tjetër mundësi për apel në procedurë pa përshpejtim.

## **15.2. Zbatimi i vendimeve të tjera nga organizatat anti-doping**

KosADA dhe secila Federatë Kombëtare në Kosovë mund të vendosin të zbatojnë vendime të tjera anti-doping të marra nga organizatat Anti-Doping që nuk përshkruhen në Nenin 15.1.1 më sipër, siç është pezullimi i përkohshëm përpara seancës së përkohshme apo pranimi nga sportisti apo personi tjetër.

## **15.3. Zbatimi i vendimeve nga organi që nuk është nënshkruar**

Vendimi antidoping nga organi që nuk është nënshkruar i kodit duhet të zbatohet nga KosADA dhe cilado Federatë Kombëtare në Kosovë, nëse KosADA konstaton se pretendohet që vendimi ka qenë brenda kompetencës së atij organi, si dhe rregullat antidoping të atij organi përndryshe janë në përputhje me kodin.

## **NENI 16 Parashkrimi**

Nuk mund të iniciohet procedura e shkeljes së rregullit anti-doping ndaj sportistit apo personit tjetër, përveç nëse ai ose ajo është njoftuar për shkeljen e rregullit antidoping siç parashikohet në nenin 7, ose janë bërë përpjekje të arsyeshme për njoftim, brenda dhjetë (10) viteve nga data kur pretendohet të ketë ndodhur shkelja.

## **NENI 17 Edukimi**

KosADA planifikon, zbaton, vlerëson dhe promovon edukimin në përputhje me kërkesat e Nenit 18.2 të Kodit dhe Standardit Ndërkombëtar për Edukimin.

## **NENI 18 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të federatave kombëtare**

**18.1.** Të gjitha Federatat Kombëtare të Kosovës dhe anëtarët e tyre duhet të respektojnë me kodin, Standardet Ndërkombëtare dhe këto Rregulla Anti-Doping. Të gjitha Federatat Kombëtare të Kosovës dhe anëtarët e tjerë duhet të përfshijnë në politikën, rregullat dhe programet e tyre dispozitat e nevojshme për njohjen e kompetencës dhe përgjegjësisë së KosADA-s për zbatimin e programit Kombëtar Anti-Doping të Kosovës dhe zbatimin e këtyre Rregullave Anti-Doping (përfshirë kryerjen e testimit), drejtpërdrejt në lidhje me sportistët dhe personat tjerë nën kompetencën e tyre anti-doping, siç specifikohet në

hyrjen e këtyre Rregullave Anti-Doping (pika “Fushëveprimi i këtyre Rregullave Anti-Doping”).

**18.2.** Secila Federatë Kombëtare e Kosovës duhet të pranojë dhe t’i përmbahet frymës dhe kushteve të programit Kombëtar Anti-Doping të Kosovës dhe këtyre rregullave Anti-Doping, si kusht për pranimin e ndihmës financiare dhe/apo ndihmave tjera nga Qeveria e Kosovës dhe/ose Komiteti Olimpik i Kosovës.

**18.3.** Secila Federatë Kombëtare e Kosovës duhet t’i përfshijë këto Rregulla Anti-Doping ose drejtpërdrejt ose me anë të referimit në dokumentet e veta rregulluese, statutit dhe/ose rregullave si pjesë e rregullave të sportit që obligojnë anëtarët e tyre në atë mënyrë që Federata Kombëtare t’i zbatojë ato vetë drejtpërdrejt për sa i përket sportistëve dhe personave të tjerë nën kompetencën e tyre antidoping.

**18.4.** Me pranimin e këtyre Rregullave Anti-Doping dhe përfshirjen e tyre në dokumentet e tyre rregulluese dhe rregullat e sportit, Federatat Kombëtare bashkëpunojnë dhe mbështesin KosADA-n në këtë funksion. Ato gjithashtu duhet të njohin, respektojnë dhe zbatojnë vendimet e marra në përputhje me këto Rregulla Anti-Doping, duke përfshirë vendimet që shqiptojnë sanksione ndaj personave nën kompetencën e tyre.

**18.5.** Të gjitha Federatat Kombëtare të Kosovës dhe anëtarët e tyre duhet të ekzekutojnë pajtueshmërinë me kodin, Standardet Ndërkombëtare dhe këto Rregulla Anti-Doping, mes tjerash, duke:

**(i)** kryer testime vetëm nën kompetencën e dokumentuar të Federatës së tyre Ndërkombëtare dhe përdorimin e kompetencës së KosADA-s apo autoriteteve të tjera për marrjen e mostrave në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet;

**(ii)** njohur kompetencën e KosADA-s në pajtim me nenin 5.2.1 të kodit dhe duke ndihmuar, sipas rastit, me zbatimin nga KosADA të programit kombëtar të testimit për sportin e tyre;

**(iii)** analizuar gjitha mostrat e marra përmes një laboratorit të akredituar nga WADA ose të aprovuar nga WADA në pajtim me Nenin 6.1; dhe

**(iv)** siguruar që secili rast i shkeljes së rregullave anti-doping në nivel kombëtar të zbuluar nga Federatat Kombëtare të gjykohet nga një kolegji shqyrtues funksionalisht i pavarur në pajtim me Nenin 8.1 dhe Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve.

**18.6.** Të gjitha Federatat Kombëtare duhet të vendosin rregulla që kërkojnë nga të gjithë sportistët që përgatiten ose marrin pjesë në garë apo aktivitete të autorizuar ose organizuar nga Federata Kombëtare apo cilado nga organizatat anëtare të saj, si dhe i gjithë personeli mbështetës i sportistëve që lidhen me ata sportistë të pajtohen të obligohen për këto Rregulla Anti-Doping, si dhe t'i nënshtrohen kompetencës së Menaxhimit të Rezultateve të Organizatës Anti- Doping në pajtim me kodin si kusht për pjesëmarrjen e tillë.

**18.7.** Të gjitha Federatat Kombëtare duhet t'i raportojnë KosADA-s dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare për çdo informatë që sugjeron ose lidhet me shkelje të rregullave anti-doping dhe duhet të bashkëpunojnë me hetimet e kryera nga cilado Organizatë Anti-Doping me kompetencë për të kryer hetimin.

**18.8.** Të gjitha Federatat Kombëtare duhet të kenë rregulla disiplinore që pengojnë personelin mbështetës të sportistëve që përdorin substanca të ndaluara apo metoda të ndaluara pa arsye të vlefshëm nga ofrimi i mbështetjes për sportistët nën kompetencën e KosADA-s ose Federatës Kombëtare.

**18.9.** Të gjitha Federatat Kombëtare duhet të ofrojnë edukim kundër Dopingut në koordinim me KosADA-n.

## **NENI 19 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të KosADA-s**

**19.1.** Përveç roleve dhe përgjegjësiave të përshkruara në nenin 20.5 të kodit për organizatat Kombëtare Anti-Doping, KosADA i raporton WADA-s për pajtueshmërinë e KosADA-s me kodin dhe Standardet Ndërkombëtare në përputhje me nenin 24.1.2 të kodit.

**19.2.** Sipas ligjit në fuqi dhe në pajtim me nenin 20.5.10 të kodit, të gjithë anëtarët e bordit të KosADA-s, drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe ata të palëve të treta të deleguara të

emëruara që angazhohen në cilindo aspekt të kontrollit të Dopingut, duhet të nënshkruajnë një formular të dhënë nga KosADA, ku pajtohen të obligohen për këto Rregulla Anti-Doping si persona në pajtim me kodin për kundërvajtje të drejtpërdrejta dhe të qëllimshme.

**19.3.** Sipas ligjit në fuqi, dhe në pajtim me nenin 20.5.11 të kodit, çdo punonjës i KosADA-s i cili angazhohet në kontrollin e Dopingut (përveç programeve të autorizuara të edukimit antidoping ose rehabilitimit) duhet të nënshkruajë një deklaratë të dhënë nga KosADA që konfirmon se janë nuk janë pezulluar përkohësisht ose nën periudhë të papranueshmërisë dhe nuk janë përfshirë drejtpërdrejt ose qëllimisht në sjellje, brenda gjashtë (6) viteve të mëparshme, të cilat do të përbënin shkelje të rregullave anti-doping nëse rregullat në pajtim me kodin do të vlenin për ta.

## **NENI 20 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të sportistëve**

**20.1.** Të kenë njohuri dhe të respektojnë këto rregulla Anti-Doping.

**20.2.** Të jenë në dispozicion për marrjen e mostrave gjatë gjithë kohës

**20.3.** Të marrin përgjegjësinë, në kontekstin e antidopingut, për atë që hanë dhe përdorin.

**20.4.** Të informojnë personelin mjekësor për detyrimin e tyre për të mos përdorur substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara dhe të marrin përgjegjësinë për t'u siguruar që asnjë trajtim mjekësor i pranuar nuk shkel këto Rregulla Anti-Doping.

**20.5.** T'i shpalosin KosADA-s dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare çdo vendim nga palët jo-nënshkruese që konstaton se sportisti ka kryer shkelje të rregullave anti-doping brenda dhjetë (10) viteve të mëparshme.

**20.6.** Të bashkëpunojnë me organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave antidoping.

Dështimi nga sportisti për të bashkëpunuar plotësisht me organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave anti-doping mund të rezultojë me akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

**20.7.** Të shpalosin identitetin e personelit mbështetës të sportistëve sipas kërkesës nga KosADA ose Federata Kombëtare, ose ndonjë organizatë tjetër Anti-Doping me kompetencë mbi sportistin.

**20.8.** Sjellja fyese e një sportisti ndaj një zyrtari të kontrollit të Dopingut ose personit tjetër të angazhuar në kontrollin e dopingut, gjë që përndryshe nuk përbën pengim, mund të rezultojë në akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

## **NENI 21 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të personelit mbështetës të sportistëve**

**21.1.** Të kenë njohuri dhe të respektojnë këto Rregulla Anti-Doping.

**21.2.** Të bashkëpunojnë me programin e testimit të sportistëve.

**21.3.** Të përdorin ndikimin e tyre në vlerat dhe sjelljen e sportistit për të nxitur qëndrime anti-doping.

**21.4.** T'i shpalosin KosADA-s dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare çdo vendim nga palët jo-nënshkruese që konstaton se kanë kryer shkelje të rregullave anti-doping brenda dhjetë (10) viteve të mëparshme.

**21.5.** Të bashkëpunojnë me Organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave antidoping.

Dështimi nga personeli mbështetës i sportistëve për të bashkëpunuar plotësisht me Organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave anti-doping mund të rezultojë me akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

**21.6.** Personeli mbështetës i sportistëve nuk mund të përdorë e as posedojë substance të ndaluara apo metoda të ndaluara pa pasur arsytim të vlefshëm. Çdo përdorim apo posedim i tillë mund të rezultojë me akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

**21.7.** Sjellja fyese e personelit mbështetës të sportistit ndaj një zyrtari të kontrollit të dopingut ose personit tjetër të angazhuar në Kontrollin e Dopingut, që përndryshe nuk përbën pengim, mund të rezultojë në akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

## **NENI 22 Rolet dhe përgjegjësitë plotësuese të personave të tjerë që i nënshtrohen këtyre rregullave anti-doping**

**22.1.** Të kenë njohuri dhe të respektojnë këto Rregulla Anti-Doping.

**22.2.** T'i shpalosin KosADA-s dhe Federatës së tyre Ndërkombëtare çdo vendim nga palët jo-nënshkruese që konstaton se kanë kryer shkelje të rregullave anti-doping brenda dhjetë (10) viteve të mëparshme.

**22.3.** Të bashkëpunojnë me Organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave antidoping.

Dështimi nga cilido person tjetër që i nënshtrohet këtyre rregullave anti-doping për të bashkëpunuar plotësisht me organizatat Anti-Doping që hetojnë shkeljet e rregullave anti-doping mund të rezultojë me akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

**22.4.** Të mos përdorin e as posedojnë substanca të ndaluara apo metoda të ndaluara pa pasur arsyetim të vlefshëm.

**22.5.** Sjellja fyese e një personi ndaj një zyrtari të Kontrollit të Dopingut ose personit tjetër të angazhuar në Kontrollin e Dopingut, që përndryshe nuk përbën pengim, mund të rezultojë në akuza për kundërvajtje sipas rregullave disiplinore të KosADA-s.

## **NENI 23 Interpretimi i kodit**

**23.1.** Teksti zyrtar i kodit mirëmbahet nga WADA dhe publikohet në anglisht dhe frëngjisht. Në rast mospërputhjeje midis versionit anglisht dhe atij frëngjisht, versioni në anglisht mbizotëron.

**23.2.** Komentet e bëra ndaj dispozitave të ndryshme të kodit përdoren për të interpretuar kodin.

**23.3.** Kodi interpretohet si tekst i pavarur dhe autonom, si dhe pa iu referuar ligjit ose statutit ekzistues të nënshkruesve ose qeverive.



**23.4.** Titujt e përdorur për pjesët dhe nenet e ndryshme të kodit janë vetëm për lehtësi leximi, si dhe nuk konsiderohen si pjesë e substancës së kodit e as që ndikojnë në ndonjë mënyrë formulimin e dispozitave të cilave ato i referohen.

**23.5.** Kur termi “ditë” përdoret në kod ose në Standard Ndërkombëtar, ai nënkupton ditë kalendarike, përveç kur specifikohet ndryshe.

**23.6.** Kodi nuk zbatohet në mënyrë retroaktive për rastet e patrajuara përpara datës kur kodi është pranuar nga nënshkruesi dhe zbatohet në rregullat e tij. Megjithatë, shkeljet e rregullave anti-doping para kodit vazhdojnë të llogariten si “Shkelje të para” apo “Shkelje të dyta” për qëllime të përcaktimit të sanksioneve sipas nenit 10 për shkeljet e mëvonshme pas kodit.

**23.7.** Qëllimi, fushëveprimi dhe organizimi i Programit Botëror Anti-Doping dhe kodi dhe shtojca 1, përkufizimet, dhe shtojca 2, shembuj të zbatimit të Nenit 10, konsiderohen pjesë përbërëse të kodit.

## **NENI 24 Dispozitat përfundimtare**

**24.1.** Kur termi “ditë” përdoret në këto Rregulla Anti-Doping, ai nënkupton ditë kalendarike, përveç kur specifikohet ndryshe.

**24.2.** Këto Rregulla Anti-Doping interpretohen si tekst i pavarur dhe autonom, si dhe pa iu referuar ligjit ose statutit ekzistues të nënshkruësve ose qeverive.

**24.3.** Këto Rregulla Anti-Doping janë miratuar në pajtim me dispozitat e zbatueshme të kodit dhe Standardeve Ndërkombëtare dhe interpretohen në mënyrën që është në pajtim me dispozitat e zbatueshme të kodit dhe Standardeve Ndërkombëtare. Kodi dhe Standardet Ndërkombëtare konsiderohen pjesë përbërëse të këtyre Rregullave Anti-Doping dhe mbizotërojnë në rast konflikti.

**24.4.** Hyrja dhe shtojca 1 konsiderohen pjesë përbërëse të këtyre Rregullave Antidoping.

**24.5.** Komentet lidhur me dispozita të ndryshme të këtyre Rregullave Anti-Doping përdoren për të interpretuar këto Rregulla Anti-Doping.

**24.6.** Këto Rregulla Anti-Doping hyjnë në fuqi më 1 janar 2021 (“Data e hyrjes në fuqi”). Ato shfuqizojnë Rregullat Anti-Doping të KosADA-s që kanë hyrë në fuqi më 1 mars 2019.

**24.7.** Këto Rregulla Anti-Doping nuk zbatohen në mënyrë retroaktive për çështjet e patrajuara përpara datës së hyrjes në fuqi. Megjithatë:

**24.7.1.** Shkeljet e rregullave antidoping që kanë ndodhur përpara datës së hyrjes në fuqi llogariten si “shkelje të para” apo “shkelje të dyta” për qëllime të përcaktimit të sanksioneve sipas nenit 10 për shkeljet që ndodhin pas datës së hyrjes në fuqi.

**24.7.2.** Çdo rast i shkeljes së rregullit anti-doping që është në trajtim në datën e hyrjes në fuqi dhe çdo rast i shkeljes së rregullit antidoping i ngritur pas datës në fuqi, bazuar në shkelje të rregullit antidoping që ka ndodhur përpara datës së hyrjes në fuqi, rregullohet me nga rregullat materiale anti-doping në fuqi në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar e rregullit anti-doping, dhe jo me rregullat materiale anti-doping të përcaktuara në këto Rregulla Anti-Doping, përveç rasteve kur kolegji që shqyrton çështjen vendos që parimi “lex mitior” vlen përshtatshmërisht në rrethanat e rastit. Për këto qëllime, periudhat retrospektive në të cilat shkeljet e mëparshme mund të trajtohen për qëllime të shkeljeve të shumëfishta sipas nenit 10.9.4 dhe parashkrimit të paraparë me nenin 16 janë rregulla procedurale, jo rregulla materiale, si dhe duhet të zbatohen në mënyrë retroaktive së bashku me të gjitha rregullat tjera procedurale në këto Rregulla Anti-Doping (me kusht që neni 16 zbatohet në mënyrë retroaktive vetëm nëse periudha e parashkrimit nuk ka skaduar në datën e hyrjes në fuqi).

**24.7.3.** Çdo dështim i sigurimit të vendndodhjes sipas nenit 2.4 (qoftë dështim i parashkrimit të informatave apo shmangie e testit, siç parashihen këto terma në Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve) përpara datës së hyrjes në fuqi, bartet përpara dhe mund të merret si bazë, para skadimit, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve, por konsiderohet se ka skaduar dymbëdhjetë (12) muaj pasi ka ndodhur.

**24.7.4.** Në lidhje me rastet kur vendimi i prerë që konstaton shkeljen e rregullit anti-doping është marrë para datës së hyrjes në fuqi, por sportisti apo personi tjetër është ende duke vuajtur periudhën e papranueshmërisë që nga data e hyrjes në fuqi, sportisti apo personi

tjetër mund t'i drejtohet KosADA-s apo ndonjë Organizatë tjetër Anti-Doping, që ka pasur përgjegjësinë e menaxhimit të rezultateve për shkeljen e rregullave anti-doping, për të marrë në konsideratë shkurtimin e periudhës së papranueshmërisë në dritën e këtyre Rregullave Anti- Doping. Parashtrimi i tillë duhet të bëhet para skadimit të periudhës së papranueshmërisë. Vendimi i nxjerrë mund të apelohe sipas nenit 13.2. Këto Rregulla Anti-Doping nuk zbatohen raste kur është marrë vendimi i prerë që konstaton shkelje të rregullit antidoping dhe ka skaduar periudha e papranueshmërisë.

**24.7.5.** Për qëllime të vlerësimit të periudhës së papranueshmërisë për shkelje të dytë sipas nenit 10.9.1, kur sanksioni për shkeljen e parë është përcaktuar në bazë të rregullave në fuqi para datës së hyrjes në fuqi, aplikohet periudha e papranueshmërisë që do të ishte vlerësuar për atë shkelje të parë, nëse këto Rregulla Anti-Doping do të ishin në fuqi.

**24.7.6.** Ndryshimet në listën e ndaluar dhe dokumentet teknike në lidhje me substancat ose metodat në listën e ndaluar nuk zbatohen në mënyrë retroaktive, përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe. Sidoqoftë, si përjashtim, kur substanca e ndaluar ose metoda e ndaluar është hequr nga lista e ndaluar, sportisti apo personi tjetër që aktualisht vuan periudhën e papranueshmërisë për shkak të substancës së ndaluar ose të metodës së ndaluar më parë mund të aplikojë tek KosADA ose një organizatë tjetër Anti-doping që ka pasur përgjegjësinë e menaxhimit të rezultateve për shkeljen e rregullave anti-doping të shqyrtonte shkurtimin e periudhës së papranueshmërisë duke marrë parasysh heqjes së substancës ose metodës nga lista e ndaluar.

## SHTOJCA 1 PËRKUFIZIMET

**ADAMS:** Sistemi i Administrimit dhe Menaxhimit Anti-Doping është vegël e menaxhimit të databazës me bazë në internet për futjen, ruajtjen, ndarjen dhe raportimin e të dhënave, krijuar për të ndihmuar palët e interesit dhe WADA-n në operacionet e tyre antidoping në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

**Administrimi:** Sigurimi, furnizimi, mbikëqyrja, lehtësimi ose pjesëmarrja ndryshe në përdorimin ose tentativën e përdorimit nga personi tjetër i një substance të ndaluar ose metode të ndaluar. Megjithatë, ky përkufizim nuk përfshin veprimet e personelit mjekësor të mirëfilltë në lidhje me substancën e ndaluar apo metodën e ndaluar të përdorur për qëllime terapeutike të mirëfillta dhe të ligjshme, apo arsyetime të tjera të pranueshme, si dhe nuk përfshin veprime që kanë të bëjnë me substanca të ndaluara që nuk janë të ndaluara në testimin jashtë garës, përveç rasteve kur rrethanat në tërësi tregojnë se substanca të tilla të ndaluara nuk janë të destinuara për qëllime terapeutike të mirëfillta e të ligjshme, ose kanë për qëllim të rrisin performancën sportive.

**Konstatimi analitik negativ:** Raport nga një laborator i akredituar nga WADA ose laborator tjetër i aprovuar nga WADA që, në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët, vërteton në mostër praninë e ndonjë substance të ndaluar apo metabolitëve ose markerëve të saj, ose dëshmi të përdorimit të një metode të ndaluar.

**Konstatim negativ në pasaportë:** Raport i identifikuar si konstatim negativ në pasaportë siç përshkruhet në Standardet Ndërkombëtare të zbatueshme.

**Rrethanat rënduese:** Rrethanat që përfshijnë, ose veprime, nga një sportist apo person tjetër që mund të çojnë në shqiptimin e periudhës së papranueshmërisë më të gjatë sesa sanksioni standard. Rrethanat dhe veprimet e tilla përfshijnë, por pa u kufizuar në to: Sportistin apo personin tjetër që ka përdorur apo poseduar substanca të ndaluara ose metoda të ndaluara të shumëfishta, ka përdorur apo poseduar substancë të ndaluar apo metodë të ndaluar në disa raste, ose që ka kryer shkelje të shumëfishta të rregullave të tjera anti-doping; individ normal ka gjasë të gëzojë efektet e rritjes së performancës të shkeljes(eve) të rregullave anti-doping përtej periudhës së papranueshmërisë që përndryshe do të vlente; sportisti apo personi i përfshirë në sjellje mashtruese ose penguese për të shmangur zbulimin ose gjykimin e shkeljes së rregullit anti-doping; ose sportisti apo personi tjetër i përfshirë në pengim gjatë menaxhimit të rezultateve. Për shmangien e dyshimit, shembujt e rrethanave dhe sjelljeve të përshkruara këtu nuk janë ekskluzive, si dhe mund të ketë rrethana apo sjellje të tjera të ngjashme që mund t'i japin bazë shqiptimit të një periudhe më të gjatë të papranueshmërisë.

**Aktivitetet anti-doping:** Edukimi dhe informimi kundër dopingut, planifikimi i shpërndarjes së testeve, mbajtja e grupimit të regjistruar të testimit, menaxhimi i pasaportave biologjike të sportistëve, kryerja e testimit, organizimi i analizave të mostrave, mbledhja e inteligjencës dhe kryerja e hetimeve, përpunimi i kërkesave për

TUE, menaxhimi i rezultateve, monitorimi dhe zbatimi i pajtueshmërinë me pasojat e mundshme të shqiptuara, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera që lidhen me anti-dopingun që duhen realizuar nga, ose në emër të, Organizatës Anti- Doping, siç parashihet me Kod dhe/ose Standardet Ndërkombëtare.

**Organizata Anti-Doping:** WADA ose pala nënshkruese që është përgjegjëse për miratimin e rregullave për iniciimin, zbatimin apo përmbartimin e cilësdo pjesë të procesit të kontrollit të dopingut. Kjo përfshin, për shembull, Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, Komitetin Paraolimpik Ndërkombëtar, Organizata të tjera të Ngjarjeve të Mëdha që kryejnë testime në ngjarjet e tyre, Federatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Kombëtare Anti-Doping.

**Sportisti:** Secili person që garon në sport në nivel ndërkombëtar (siç parashihet nga secila Federatë Ndërkombëtare) ose në nivel kombëtar (siç parashihet nga secila Organizatë Kombëtare Anti-Doping). Organizata Anti-Doping ka lirinë e veprimit për të zbatuar rregullat anti-doping për sportistin që nuk është as sportist i nivelit ndërkombëtar dhe as sportist i nivelit kombëtar, ashtu që t'i përfshijë edhe ata brenda përkufizimit të "Sportistit". Në lidhje me sportistët që nuk janë as sportistë të nivelit ndërkombëtar dhe as kombëtar, Organizata Anti-Doping mund të zgjedhë: të kryejë testime të kufizuara ose të mos testojë fare; të analizojë mostrat për më pak se menyuja e plotë e Substancave të Ndaluara; të kërkojnë informata të kufizuara ose jo të vendndodhjes; ose të mos kërkojnë TUE paraprake. Megjithatë, nëse shkelja e rregullit antidoping të Nenit 2.1, 2.3 ose 2.5 kryhet nga cilido sportist ndaj të cilit Organizata Anti-Doping ka zgjedhur të ushtrojë kompetencën e saj për të testuar dhe që garon në nivel ndërkombëtar ose kombëtar, atëherë pasojat e parapara në Kod duhet të zbatohen. Për qëllime të nenit 2.8 dhe nenit 2.9 dhe për qëllime të informimit dhe edukimit kundër dopingut, secili person që merr pjesë në sport nën kompetencën e cilësdo nënshkruesi, qeverie ose organizate tjetër sportive që pranon Kodin është Sportist.

**Pasaporta Biologjike e Sportistit:** Programi dhe metodat e marrjes dhe kategorizimit të të dhënave siç përshkruhet në Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet dhe Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët.

**Personeli mbështetës i sportistëve:** Secili trajner, stërvitës, menaxher, agjent, staf ekipi, zyrtar, personel mjekësor, infermier, prind apo cilido person tjetër që punon, trajton ose ndihmon një sportist që merr pjesë ose përgatitet për garat sportive.

**Tentativa:** Angazhimi i qëllimshëm në veprime që përbëjnë hapa substancialë në drejtim të veprimit të planifikuar për të përfunduar me kryerjen e shkeljes së rregullit anti-doping. Megjithatë, me kusht që të mos ketë shkelje të rregullave antidoping bazuar vetëm në tentativë për të kryer shkeljen nëse personi heq dorë nga tentativa përpara se ajo të zbulohet nga pala e tretë që nuk është angazhuar në tentativë.

**Konstatimi jotipik:** Raport nga një laborator i akredituar nga WADA apo ndonjë laborator tjetër i miratuar nga WADA, që kërkon hetim të mëtejshëm siç parashihet me Standardin

Ndërkombëtar për Laboratorët ose Dokumentet Teknike përkatëse përpara përcaktimit të konstatimit analitik negativ.

**Konstatim Jotipik në pasaportë:** Raport i identifikuar si konstatim jotipik në pasaportë siç përshkruhet në Standardet Ndërkombëtare të zbatueshme.

**KAS:** Gjykata e Arbitrazhit Sportiv.

**Kodi:** Kodi Botëror Anti-Doping.

**Gara:** Një garë e vetme, ndeshje, lojë apo një garë sportive e vetme. Për shembull, një ndeshje basketbolli apo finalët e garës olimpike 100 metra në sport. Për garat me faza dhe garat e tjera sportive ku çmimet jepen çdo ditë ose në baza të tjera të përkohshme, dallimi ndërmjet një gare dhe një ngjarjeje bëhet sipas dispozitave në rregullat në fuqi të Federatës Ndërkombëtare.

**Pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping (“Pasojat”):** Shkelja e rregullit anti-doping nga një sportisti apo personi tjetër mund të rezultojë me njërën apo më shumë prej pikave vijuese: (a) Diskualifikim do të thotë zhvlerësim i rezultateve të sportistit në një garë apo ngjarje të caktuar, me të gjitha pasojat që rrjedhin, duke përfshirë revokimin e secilës medalje, pikëve dhe çmimeve; (b) Papranueshmëri do të thotë që sportisti apo personi tjetër përjashtohet, për shkak të shkeljes së rregullave anti-doping, për një periudhë të caktuar kohe nga pjesëmarrja në ndonjë garë apo aktivitet ose financim tjetër, siç parashihet me Nenin 10.14; (c) Pezullimi i përkohshëm nënkupton që sportisti apo personi tjetër ndalohet përkohësisht të marrë pjesë në ndonjë garë apo aktivitet përpara vendimit përfundimtar në seancë dëgjimore të mbajtur sipas nenit 8; (d) Pasojat financiare do të thonë sanksione financiar të shqiptuara për shkelje të rregullit anti-doping, apo për të rimarrë shpenzimet që lidhen me shkeljen e rregullit anti-doping; si dhe (e) Shpalsja publike nënkupton ndarjen apo shpërndarjen e informacionit për publikun e gjerë apo Personat përtej atyre Personave që kanë të drejtë për njoftim të mëhershëm në pajtim me nenin 14. Ekipet në sportet ekipore gjithashtu mund të jenë subjekt i pasojave siç parashihet me nenin 11.

**Produkt i kontaminuar:** Produkt që përmban substancë të ndaluar që nuk shpaloset në etiketën e produktit apo në informacionin e disponueshëm në një kërkim të arsyeshëm në internet.

**Kufiri i vendimit:** Vlera e rezultatit për pragun e substancës në mostër, mbi të cilin raportohet konstatimi analitik negativ, siç parashihet me Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët.

**Palë e tretë e deleguar:** Secili person të cilit KosADA i delegon cilindo aspekt të programeve të edukimit të kontrollit të dopingut ose antidopingut, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, palët e treta apo organizata të tjera anti-doping që bëjnë marrjen e mostrave apo shërbime të tjera të kontrollit të dopingut ose programe edukative antidoping për KosADA, ose individë që shërbejnë si kontraktorë të pavarur e që kryejnë shërbime të kontrollit të Dopingut për KosADA (p.sh., zyrtarë apo përcjellës të kontrollit të Dopingut që nuk janë të punësuar). Ky përkufizim nuk përfshin KAS.

**Diskualifikimi:** Shih Pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping.

**Kontrolli i dopingut:** Të gjithë hapat dhe proceset nga planifikimi i shpërndarjes së testeve deri te mbyllja përfundimtare e procedurave të apelit dhe ekzekutimi i pasojave, duke përfshirë të gjithë hapat dhe proceset midis tyre, duke përfshirë por pa u kufizuar në to, testimin, hetimet, vendndodhjen, TUE-të, marrjen dhe trajtimin e mostrave, analizat laboratorike, menaxhimin e rezultateve, si dhe hetimet ose procedurat në lidhje me shkeljet e Nenit 10.14 (Statusi gjatë papranueshmërisë ose pezullimi i përkohshëm).

**Edukimi:** Procesi i të mësuarit për të rrënjosur vlerat dhe për të zhvilluar sjellje që nxisin dhe mbrojnë frymën sportive, si dhe për të parandaluar dopingun e qëllimshëm dhe të paqëllimshëm.

**Ngjarja:** Një sërë garash individuale të zhvilluara së bashku nën kompetencën e një organi drejtues (p.sh. Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore të një Federate Ndërkombëtare, apo Lojërat Panamerikane).

**Periudha e ngjarjes:** Koha midis fillimit dhe përfundimit të ngjarjes, siç parashihet nga organi drejtues i ngjarjes.

**Vendet e ngjarjeve:** Ato vende të caktuara nga organi qeverisës për ngjarjen.

**Fajësia:** Fajësia është secila shkelje e detyrës apo mungesë kujdesi që është i domosdoshëm për situatën e caktuar. Faktorët që duhen marrë parasysh në vlerësimin e shkallës së fajësisë së sportistit apo personit tjetër përfshijnë, për shembull, përvojën e sportistit apo personit tjetër, nëse sportisti apo personi tjetër është person i mbrojtur, konsiderata të veçanta si dëmtimi, shkalla e rrezikut që duhej perceptuar nga sportisti dhe niveli i kujdesit dhe hetimit të ushtruar nga sportisti në lidhje me atë që duhej të ishte niveli i perceptuar i rrezikut. Në vlerësimin e shkallës së fajësisë së sportistit apo personit tjetër, rrethanat e marra në shqyrtim duhet të jenë specifike dhe relevante për të shpjeguar mosveprimin e sportistit apo personit tjetër sipas standardit të pritur të sjelljes. Kështu, për shembull, fakti që sportisti do të humbiste mundësinë për të fituar shuma të mëdha parash gjatë periudhës së papranueshmërisë, apo fakti që sportistit i ka mbetur kohë e shkurtër në karrierë, ose koha e kalendarit sportiv, nuk do të ishin faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh në shkurtimin e periudhës së papranueshmërisë sipas nenit 10.6.1 ose 10.6.2.

**Pasojat financiare:** Shih Pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping.

**Gjatë garës:** Periudha që fillon në orën 23:59 të ditës para një gare në të cilën sportisti është planifikuar të marrë pjesë deri në përfundimin e garës së tillë dhe procesin e marrjes së mostrave në lidhje me atë garë. Megjithatë, me kusht që WADA mund të miratojë, për sport të caktuar, përkufizim alternativ nëse Federata Ndërkombëtare ofron arsytim bindës se një përkufizim tjetër është i nevojshëm për sportin e saj; pas miratimit të tillë nga WADA, përkufizimi alternativ do të ndiqet nga të gjitha Organizatat e Ngjarjeve të mëdha për atë sport të veçantë.

**Programi i vëzhguesve të pavarur:** Ekip vëzhguesish dhe/ose auditorësh, nën mbikëqyrjen e WADA-s, të cilët vëzhgojnë dhe ofrojnë udhëzime mbi procesin e Kontrollit të Dopingut përpara ose gjatë ngjarjeve të caktuara dhe raportojnë për vërtetimet e tyre si pjesë e programit të monitorimit të pajtueshmërisë së WADA-s.

**Sport individual:** Secili sport që nuk është sport ekipor.

**Papranueshmëria:** Shih pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping si më lart.

**Pavarësia institucionale:** Kolegjet shqyrtuese në apel duhet të jenë plotësisht të pavarura institucionalisht nga Organizata Anti-Doping përgjegjëse për Menaxhimin e Rezultateve. Prandaj, ato në asnjë mënyrë nuk duhet të administrohen, të lidhen ose t'i nënshtrohen Organizatës Anti-Doping përgjegjëse për Menaxhimin e Rezultateve.

**Ngjarje ndërkombëtare:** Ngjarje ose garë ku Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Komiteti Ndërkombëtar Paralimpik, Federata Ndërkombëtare, Organizata e Ngjarjeve të Mëdha apo ndonjë organizatë tjetër sportive ndërkombëtare është organi qeverisës për ngjarjen ose emëron zyrtarët teknikë për ngjarjen.

**Sportist i nivelit ndërkombëtar:** Sportistët që konkurrojnë në sport në nivel ndërkombëtar, siç përcaktohet nga secila Federatë Ndërkombëtare, në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Testimin dhe Hetimet.

**Standardi Ndërkombëtar:** Standard i miratuar nga WADA në mbështetje të Kodit. Pajtueshmëria me standardin ndërkombëtar (krahasuar me ndonjë standard, praktikë ose procedurë tjetër alternative) mjafton për të arritur në përfundimin se procedurat e trajtuara nga Standardi Ndërkombëtar janë kryer siç duhet. Standardet Ndërkombëtare përfshijnë çdo Dokument Teknik të nxjerrë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar.

**Organizatat e Ngjarjeve të Mëdha:** Shoqatat kontinentale të Komiteteve Olimpike Kombëtare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare multi-sportive që funksionojnë si organ rregullues për çdo ngjarje kontinentale, rajonale ose të tjera ndërkombëtare.

**Markeri:** Përbërje, grup përbërjesh apo variabël(a) biologjike që tregojnë përdorimin e substancës së ndaluar apo metodës së ndaluar.

**Metaboliti:** Secila substancë e prodhuar nga një proces biotransformimi.



**Niveli minimal i raportimit:** Përqendrimi i përlogaritur i një Substance të Ndaluar apo Metabolitit(ëve) ose Markerit(ëve) në një mostër nën të cilin laboratorët e akredituar nga WADA nuk raportojnë mostrën si konstatim analitik negative.

**I/e mitur:** Person fizik i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

**Organizatë Kombëtare Anti-Doping:** Subjekti(et) e caktuara nga secili vend si bartës i kompetencës dhe përgjegjesisë parësore për të miratuar dhe zbatuar rregullat anti-doping, për të drejtuar mbledhjen e mostrave, menaxhimin e rezultateve të testeve dhe zhvillimin e seancave dëgjimore në nivel kombëtar. Nëse ky përcaktim nuk bëhet nga autoriteti(et) publike kompetente, subjekti do të jetë Komiteti Olimpik Kombëtar i vendit ose një tjetër i deleguar nga ai. Në Kosovë, Organizata Kombëtare Anti-Doping është KosADA.

**Ngjarje Kombëtare:** Ngjarje ose garë sportive që përfshin sportistë të nivelit ndërkombëtar ose kombëtar që nuk është ngjarje ndërkombëtare.

**Federata Kombëtare:** Subjekt kombëtar ose rajonal në Kosovë që është anëtar ose njihet nga Federata Ndërkombëtare si subjekt që qeveris sportin e Federatës Ndërkombëtare në atë shtet apo rajon në KosADA.

**Sportist i nivelit shtetëror:** Sportistët që garojnë në sport në nivel ndërkombëtar, siç përcaktohet nga secila Federatë Ndërkombëtare, në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet. Në Kosovë, sportistët e nivelit kombëtar përcaktohen siç parashihet në hyrjen e këtyre Rregullave Anti-Doping (Pjesa “Fushëveprimi i këtyre Rregullave Anti- Doping”).

**Komiteti Olimpik Kombëtar:** Organizatë e njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Termi Komiteti Olimpik Kombëtar përfshin gjithashtu Konfederatën Kombëtare të Sporteve në ato vende ku Konfederata Kombëtare e Sporteve merr përsipër përgjegjësitë tipike të Komitetit Olimpik Kombëtar në fushën anti-doping. Në Kosovë Komiteti Olimpik Kombëtar është (Komiteti Olimpik i Kosovës).

**Pa fajësi apo pakujdesi:** Sportisti apo personi tjetër konstaton se ai ose ajo nuk ka ditur e as nuk ka dyshuar, si dhe nuk ka mundur të dijë e as të dyshojë në masë të arsyeshme, edhe me kujdesin maksimal, se ai ose ajo ka përdorur apo administruar substanca të ndaluara apo metoda të ndaluara ose përndryshe ka shkelur rregullin antidoping. Me përjashtim të rastit të personit të mbrojtur apo sportistit rekreativ, për cilëndo shkelje të Nenit 2.1, sportisti duhet të demonstrojë gjithashtu se si substanca e ndaluar ka hyrë në sistemin e sportistit.

**Pa fajësi apo pakujdesi të konsiderueshme:** Konstatimi i sportistit apo një personi tjetër se çfarëdo fajësie apo pakujdesie, kur shihet në tërësinë e rrethanave dhe duke marrë parasysh kriteret për fajësi apo pakujdesi, nuk ishte e konsiderueshme në raport me shkeljen e rregullit anti-doping. Me përjashtim të rastit të personit të mbrojtur apo sportistit rekreativ, për cilëndo shkelje të Nenit 2.1, sportisti duhet të demonstrojë gjithashtu se si substanca e ndaluar ka hyrë në sistemin e sportistit.

**Pavarësia Funktionale:** Kjo do të thotë që 1) anëtarët e bordit, anëtarët e stafit, anëtarët e komisionit, konsulentët dhe zyrtarët e Organizatës Anti-Doping me përgjegjësi për Menaxhimin e Rezultateve ose filialet e saj (p.sh., federata ose konfederata anëtare), si dhe çdo person i përfshirë në hetim dhe fazën paraprake të gjykimit të rastit nuk mund të emërohet si anëtar dhe/apo nëpunës (në masën që nëpunësi angazhohet në procesin e shqyrtimit dhe/ose hartimit të ndonjë vendimi) të kolegjeve shqyrtuese të asaj Organizate Anti-Doping me përgjegjësi për menaxhimin e rezultateve dhe (2) kolegjet shqyrtuese duhet të jenë në gjendje të drejtojnë procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes pa ndërhyrje nga Organizata Anti-Doping apo ndonjë palë e tretë. Qëllimi është të sigurohet që anëtarët e kolegjit shqyrtues apo individët e angazhuar ndryshe në vendimin e kolegjit shqyrtues, të mos angazhohen në hetimin, apo vendimet për trajtimin, e rastit.

**Jashtë garës:** Secila periudhë që nuk është gjatë garës.

**Pjesëmarrës:** Secili sportist apo person mbështetës i sportistit.

**Personi:** Person fizik apo një organizatë apo subjekt tjetër.

**Posedimi:** Posedimi aktual, fizik ose konstruktiv (që konstatohet vetëm nëse personi ka kontroll ekskluziv ose synon të ushtrojë kontroll mbi substancën e ndaluar ose metodën e ndaluar ose mjediset në të cilat ekziston substanca e ndaluar ose metoda e ndaluar); megjithatë, me kusht që nëse personi nuk ka kontroll ekskluziv mbi substancën e ndaluar ose metodën e ndaluar ose mjediset në të cilat ekziston substanca e ndaluar apo metoda e ndaluar, posedimi konstruktiv konstatohet vetëm nëse personi ka ditur për praninë e substancës së ndaluar apo metoda e ndaluar dhe ka synuar të ushtrojë kontroll mbi të. Megjithatë, me kusht që të mos ketë shkelje të rregullit anti-doping bazuar vetëm në posedim nëse, përpara marrjes së njoftimit të çfarëdo lloji se Personi ka kryer shkelje të rregullit antidoping, personi ka ndërmarrë veprime konkrete që tregojnë se personi nuk ka pasur kurrë qëllim të gëzojë posedim dhe ka hequr dorë nga posedimi duke ia deklaruar shprehimisht një Organizate Anti- Doping. Pa anashkaluar asnjë dispozitë që thotë të kundërtën në këtë definicion, blerja (përfshirë blerjen në mënyrë elektronike apo tjetër) të një substance të ndaluar apo metode të ndaluar përbën posedim nga personi që bën blerjen.

**Lista e Ndaluar:** Lista që identifikon substancat e ndaluara dhe metodat e ndaluara.

**Metoda e ndaluar:** Secila metodë e përshkruar në Listën e Ndaluar.

**Substanca e ndaluar:** Çdo substancë, ose klasë substancash, të përshkruara në Listën e Ndaluar.

**Personi i mbrojtur:** Sportisti apo personi tjetër fizik që në momentin e shkeljes së rregullit anti-doping: (i) nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç; (ii) nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nuk është përfshirë në grupim testimi të regjistruar dhe nuk ka garuar kurrë në ndonjë ngjarje ndërkombëtare në kategori të hapur; ose (iii) për arsye të tjera përveç moshës është përcaktuar se i mungon zotësia juridike sipas legjisllacionit kombëtar në fuqi.

**Seanca e përkohshme:** Për qëllimet e nenit 7.4.3, seanca e përshpejtuar dhe e shkurtuar që mbahet përpara seancës sipas nenit 8 që i jep sportistit njoftimin dhe mundësinë për t'u dëgjuar në formë të shkruar ose verbale.

**Pezullimi i përkohshëm:** Shih pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping si më lart.

**Shpalosja publike:** Shih pasojat e shkeljeve të rregullave anti-doping si më lart.

**Sportist rekreativ:** Në Kosovë, sportisti rekreativ përcaktohet siç parashihet në hyrjen e këtyre Rregullave Anti-Doping (Pjesa "Fushëveprimi i këtyre Rregullave Anti-Doping").

**Organizatë Rajonale Anti-Doping:** Subjekt rajonal i caktuar nga shtetet anëtare për të koordinuar dhe menaxhuar fushat e deleguara të programeve të tyre kombëtare anti-doping, të cilat mund të përfshijnë miratimin dhe zbatimin e rregullave anti-doping, planifikimin dhe mbledhjen e mostrave, menaxhimin e rezultateve, rishikimin e TUE-ve, zhvillimin e seancave dëgjimore dhe zhvillimin e programeve edukative në nivel rajonal.

**Grupimi i regjistruar i testimi:** Grupimi i sportistëve me prioritetin më të lartë, krijuar veçmas në nivel ndërkombëtar nga Federatat Ndërkombëtare, si dhe në nivel kombëtar nga organizatat Kombëtare Anti-Doping, të cilët i nënshtrohen testimi të fokusuar gjatë dhe jashtë garës si pjesë e asaj Federate Ndërkombëtare ose plani i shpërndarjes së testeve të organizatës Kombëtare Anti-Doping dhe për këtë arsye obligohen të ofrojnë informatat për vendndodhje siç parashihet në nenin 5.5 të Kodit dhe Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet. Në Kosovë, grupimi i regjistruar i testimi të KosADA-s është përcaktuar siç parashihet me Nenin 5.5 të këtyre Rregullave Anti-Doping.

**Menaxhimi i rezultateve:** Procesi që përfshin afatin kohor midis njoftimit sipas nenit 5 të Standardit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Rezultateve, ose në raste të caktuara (p.sh., konstatimi atipik, pasaporta biologjike e sportistit, dështimi në ofrimin e vendndodhjes), hapa të tillë të njoftimit paraprak të paraparë shprehimisht në nenin 5 të standardit ndërkombëtar për menaxhimin e rezultateve, prej akuzës e deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit, duke përfshirë përfundimin e seancës dëgjimore në shkallë të parë ose në apel (nëse është parashtruar apeli).

**Mostra ose specimeni:** Çdo material biologjik i marrë për qëllime të kontrollit të dopingut.

**Nënshkrueset:** Subjektet që pranojnë kodin dhe pranojnë të zbatojnë kodin, siç parashihet me nenin 23 të Kodit.

**Metoda e specifikuar:** Shih nenin 4.2.2.

**Substanca e specifikuar:** Shih nenin 4.2.2.

**Përgjegjësi e ngushtë:** Rregulli që parasheh që sipas nenit 2.1 dhe nenit 2.2, nuk është e domosdoshme që dashja, fajësia, pakujdesia ose përdorimi me dije nga ana e sportistit të demonstrohet nga Organizata Anti-Doping për të konstatuar shkeljen e rregullit anti-doping.

**Substanca e abuzimit:** Shih nenin 4.2.3.

**Ndihmë substanciale:** Për qëllimet e nenit 10.7.1, personi që ofron ndihmë substanciale duhet që: (1) të shpalosë plotësisht në deklaratë me shkrim të nënshkruar ose intervistë të regjistruar të gjithë informacionin që ai ose ajo posedon në lidhje me shkeljet e rregullave anti-doping ose procedurat e tjera të përshkruara në nenin 10.7.1.1 dhe (2) të bashkëpunojë plotësisht me hetimin dhe gjykimin e cilitdo rast apo çështje që lidhet me atë informacion, duke përfshirë, për shembull, dhënien e dëshmisë në seancë dëgjimore nëse kjo kërkohet nga organizata Anti-Doping ose kolegji shqyrtues. Më tej, informacioni i dhënë duhet të jetë i besueshëm dhe duhet të përbëjë pjesë të rëndësishme të atij rasti apo procedure që inicohet, ose nëse nuk është hapur rasti apo iniciuar procedura, duhet të ofrojë bazë të mjaftueshme mbi të cilën mund të ngritet rasti apo procedura.

**Pengimi:** Sjellje e qëllimshme që pengon procesin e Kontrollit të Dopingut, por që ndryshe nuk përfshihet në përkufizimin e metodave të ndaluara. Pengimi përfshin, pa kufizim, dhënien apo marrjen e ryshfetit për të kryer ose për të mos kryer një veprim, pengimin e marrjes së mostrës, ndikimin apo pamundësimin e analizës së mostrës, falsifikimin e dokumenteve të dorëzuara në Organizatën Anti-Doping apo komitetin TUE apo kolegjin shqyrtues, sigurimin e dëshmimeve të rreme nga dëshmitarët, kryerjen e çdo akti tjetër mashtrues ndaj Organizatës Anti-Doping apo organit shqyrtues për të ndikuar në menaxhimin e rezultateve ose shqiptimin e pasojave, si dhe çdo ndërhyrje tjetër të ngjashme të qëllimshme ose në tentativë për ndërhyrje në cilindo aspekt të kontrollit të dopingut.

**Testimi i shënjestruar:** Përzgjedhja e sportistëve specifikë për testim bazuar në kriteret e përcaktuara në Standardin Ndërkombëtar për testimin dhe hetimet.

**Sport ekipor:** Sport në të cilin lejohet zëvendësimi i lojtarëve gjatë garës.

**Dokument teknik:** Dokument i miratuar dhe publikuar nga WADA herë pas here, që përmban kërkesa teknike të detyrueshme për tema specifike anti-doping, siç parashikohet në standard ndërkombëtar.

**Testimi:** Pjesët e procesit të Kontrollit të Dopingut që përfshijnë planifikimin e shpërndarjes së testeve, mbledhjen e mostrave, trajtimin e mostrës dhe transportin e mostrës në laborator.

**Përrjashtimi për përdorim terapeutik (TUE):** Përrjashtimi për përdorim terapeutik i lejon sportistit me një gjendje të caktuar mjekësore të përdorë substancë të ndaluar apo metodë të ndaluar, por vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në Nenin 4.4 dhe Standardin Ndërkombëtar për Përrjashtimet për Përdorim Terapeutik.

**Trafikimi:** Shitja, dhënia, transportimi, dërgimi, dorëzimi apo shpërndarja (apo posedimi për qëllime të tilla) të një substance të ndaluar apo metode të ndaluar (fizikisht ose në mënyrë elektronike apo tjetër) nga sportisti, personi mbështetës i sportistit apo cilido person tjetër që i nënshtrohet kompetencës së Organizatës Anti-Doping tek cilado palë e tretë; me kusht, megjithatë, që ky përkufizim të mos përfshijë veprimet e personelit

mjekësor të mirëfilltë që përfshijnë Substancë të Ndaluar të përdorur për qëllime terapeutike të mirëfillta dhe ligjore ose arsytetime të tjera të pranueshme, si dhe të mos përfshijë veprime që merren mesubstanca të ndaluara që nuk janë të ndaluara në testimin jashtë garës, përveç rasteve kur rrethanat në tërësi demonstrojnë që substancat e tilla të ndaluara nuk janë të destinuara për qëllime terapeutike të mirëfillta dhe të ligjshme apo kanë për qëllim të rrisin performancën sportive.

**Konventa e UNESCO-s:** Konventa Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, miratuar në sesionin e 33-të i Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s më 19 tetor 2005, ku përfshihet secili amendament i miratuar nga Shtetet Palë të Konventës dhe Konferenca e Palëve të Konventës Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport.

**Përdorimi:** Shfrytëzimi, aplikimi, gjëllitja, injektimi ose konsumimi me çfarëdo mënyre të ndonjë substance të ndaluar ose metodë të ndaluar.

**WADA:** Agjencia Botërore Anti-Doping.

**Marrëveshja pa paragjykim:** Për qëllimet e neneve 10.7.1.1 dhe 10.8.2, marrëveshja me shkrim midis Organizatës Anti-Doping dhe sportistit apo personit tjetër që i mundëson sportistit apo personit tjetër t'i japë informacion Organizatës Anti-Doping në aranzhime të përkufizuara kohore, me mirëkuptimin që, nëse marrëveshja për ndihmë substanciale apo marrëveshja për zgjidhjen e çështjes nuk është finalizuar, informacioni i dhënë nga sportisti apo personi tjetër në këtë aranzhim të veçantë nuk mund të përdoret nga Organizata Anti-Doping kundër sportistit apo personit tjetër në çfarëdo procedure të menaxhimit të rezultateve sipas kodit, si dhe që informacioni i dhënë nga Organizata Anti-Doping në këtë aranzhim të veçantë nuk mund të përdoret nga sportisti apo personi tjetër kundër Organizatës Anti-Doping në çfarëdo procedure të Menaxhimit të Rezultateve sipas Kodit. Marrëveshja e tillë nuk pengon Organizatën Anti-Doping, sportistin apo personin tjetër nga përdorimi i çfarëdo informacioni apo prove të mbledhur nga cilido burim tjetër, përveçse gjatë aranzhimit të kufizuar kohor të përshkruar në marrëveshje.